

**Mbledhje
e përbashkët
në Strumicë**
**Pa dilemë me
Bullgarinë**

Fq.3



**Amendamentet
e LSDM-së**
**Kundër niveli-
zimit të shqipes
me gjuhët e pakicave**

Fq.4



**Alijin do
e thërras
edhe pa
skuadër**

Panuçi

Fq.19



Koha

11 VJET ME JU

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3229 · E premte 24 nëntor 2017

-2°C | +10°C

15 DEN

AKTUALE

**Kundër
tatimit të ri**



Bujqit janë kundër vendosjes së tatimit të ri në të ardhura, që pritet të funksionojë në vitin 2018. Me ndryshimet ligjore që janë në procedurë kuvendore, parashikohet që personat që nga kopshtet e tyre ju shesin prodhimet bujqësore restoranteve dhe personave të tjerë juridik, të paguajnë tatim shtesë. Deri tani ata ishin të liruar nga pagesa e tatimit nëse kishin të ardhura deri në 300 mijë denarë. Tani në shumën duhet të paguajnë 2 për qind tatim, ose 6000 denarë, për shkak se tatimohet vetëm 20 për qind

Fq.7

RAON

**Pa SHBA-të,
s'ka marrë-
veshje me
Serbinë**

Fq.14

PROFILE

**"Zonja e
hekurt", një
sfidë për
regjimin e
Erdoganit**

Fq.13



ASNJË PROPOZIM ZYRTAR PËR NDRYSHIME NË ÇMIMET SHTETËRORE

22 NËNTORI, NJË GJYSMË FESTË QË MERITON TË BËHET "11 TETORI"

Mungesa e vëmendjes shtetërore gjatë gjithë këtyre viteve, duke filluar me restaurimet sipërfaqësore të objektit, fondet minimale që i janë akorduar nga Ministria e Kulturës, zvarritja prej një dekade e çështjes së pronësisë, mbrojtja adekuate e objektit pas tentativave për ta djegur, varret e harruara të Qiriazëve... e të tjera, do të duhej që të paktën të kompensohej me insistimin që kjo datë e rëndësishme për kulturën dhe arsimin të ishte pjesë e çmimeve shtetërore

Gjykata me standarde të dyfishta

Shkup, 23 nëntor - Mbarimi i afatit të letërnjoftimit i dëshmitarit kryesor në rastin e "Sopotit", Ramadan Bajramit, të enjten i pamundësoi dhënien e dëshmisë para Trupit gjyqësor në Gjykatën Penale të Shkupit dhe me këtë, edhe u anulua seanca gjyqësore për më 20 dhjetor. Këshilli Penal i kësaj gjykate, i kryesuar nga gjykatësja Dija-

na Gruevska Ilievska, vërtetoi se dokumenti i identifikimit i dëshmitarit të propozuar nga pala mbrojtëse është i pavlefshëm, për shkak se e drejta e shfrytëzimit i kishte mbaruar tre muaj më parë. Përveç letërnjoftimit, i cili nga Ministria e Punëve të Brendshme, dëshmitarit Ramadan Bajramit, i cili ishte ndarë në vitin 2002, ai shtoi se pose-

don edhe pasaportë, megjithatë të njëjtën nuk e mban me vete. "Në këso rrethana, kur një dokument identifikimi është i dhënë 15 vite më herët, gjegjësisht edhe fotografia shihet se është e vjetruar, ne nuk mundemi me saktësi të konstatojmë identitetin e dëshmitarit", tha gjykatësja, Gruevska Ilievska...

Fq.5



Fq.6

EDITORIAL

SIVJET,
PAK MË MIRË...!Vedat MEMEDALIU
kryeredaktor

Muzeu i Alfabetit edhe këtë vit, në përvjetorin e 109-të të saj, ishte si mos më keq. Pllakat sanitare në dyqanin privat të një tregtari maqedonas, në katin e parë të muzeut, sërish pritën shqiptarët që vizituan të mërkurën këtë muze. Dhe, sikurse viteve tjera, deklaratat e zyrtarëve shqiptarë të Qeverisë ishin se "sivjet, është pak më mirë". Vetëm kaq: "sivjet, pak më mirë"!

Muzeu i Alfabetit, aty ku dikur më shumë se gjysma e banorëve ishin shqiptarë, përmendet vetëm kur ofrohet nëntori - i njohur ndryshe si muaji i historisë shqiptare.

Edhe pse tashmë objekti në fjalë është muze shtetëror dhe nën ombrellën e Ministrisë së Kulturës, i njëjti nuk do të financohet me mjete shtetërore. Pak denarë dhe më shumë IPA Fonde, zyrtarët shqiptarë të Qeverisë në Shkup nuk treguan, së paku deri tani, këmbëngulësinë që pllakat sanitare t'i flakin tutje Shtëpisë së Alfabetit. Jo të meremtohet i tëri! Sepse, këtë të fundit nuk e bëjnë dot.

Paafësi dhe neglizhencë nuk tregojnë vetëm shqiptarët e Qeverisë së Maqedonisë. Për Muzeun e Alfabetit hesht edhe Shqipëria, edhe Kosova. Mjaftohen që, edhe atë rralë ndonjë zyrtarë i Kosovës apo Shqipërisë, të thotë ca premtime më 22 nëntor dhe kaq. Vetëm kaq, sikurse tanët që thonë "sivjet pak më mirë".

Mjafton të kujtojmë takimin e famshëm të dy viteve më parë të tre ministrave shqiptarë të Arsimit- Abdilqam Ademi i Maqedonisë, Arsim Bajrami i Kosovës dhe Lindita Nikolla e Shqipërisë, në Muzeun e Alfabetit në Manastir, e ku firmosën marrëveshjen për restaurimin e muzeut nga Instituti i Monumenteve të Shqipërisë. Kosova mori përsipër ndarjen e një shume simbolike, derisa Maqedonia u zotua për heqjen e dyqanit me pllakat sanitare.

"Instituti i monumenteve të kulturës në Shqipëri, këto ditë ka hartuar projektin e restaurimit të këtij objekti mbi bazën e kriterëve shkencore, duke ruajtur autenticitetin e vet objektit dhe njëkohësisht duke i dhënë edhe vlerat që meriton ky objekt", u pat shprehur ministrja e Arsimit e Shqipërisë. Marrëveshje, përveç restaurimit të objektit të muzeut, u pat firmosur edhe për bashkëpunim tre shtetesh në arsim... Dhe, asnjëri premtim nuk u realizua. U harru sapa mbaroi data 22 nëntor.

Njëjtë sikurse pardje, për darkën pas 22 nëntorit, nga Muzeu i Alfabetit drejt në hotel "Epinal", në Manastir. Për darkën de, festa mbaroi... deri në mot!

EDHE HARADINAJ DHE THAÇI MUND TË AKUZOHEN

Ish-diplomati amerikan dhe njohësi i çështjeve të Ballkanit, Daniel Serwer, ka reaguar ndaj verdiktit të sotëm në Hagë, ku është dënuar komandanti i ushtrisë së serbëve të Bosnjës për gjenocid dhe krime kundër njerëzimit. "Kjo është më pak e vërtetë për të akuzuarit kroat, boshnjak dhe kosovar, veçmas pse lidhshipi më i lartë i tyre nuk ishin akuzuar asnjëherë. Presidenti kroat Tudjman dhe Presidenti Izetbegovic janë të vdekur. Kryeministri Haradinaj është akuzuar dhe liruar. Tani, ai është përsëri kryeministër. Ai dhe Presidenti i Kosovës, ose figura tjera të UÇK-së ende mund të akuzohen nga Gjykata Speciale e Kosovës që përbëhet nga stafi ndërkombëtar në Hagë e që do të merret me krimet e pasluftës", shkruan në Twitter, Serwer.



PUSHTUESIT E RAMËS DHE SHQIPËRISË!

"Krenarë për Shqipërinë? Dakord! Po si do i'a bëjmë plehrave që plot krenarë ndër ne, i hedhin mbi trupin e Shqipërisë ashtu siç asnjë pushtues nuk i hodhi kurrë?! Duam një Shqipëri më të fortë? Dakord! Po si mund të bëhet më e fortë Shqipëria e sulmuar nga të katër anët nga plehurat që bijtë e saj hedhin kudo?! Shqipëria destinacion i ri turistik në Mesdhe? Dakord! Po si do ta heqim njollën e turpfit që i vëmë vetes në sytë e çdo turisti që mrekullohet nga bukuritë e këtij vendi dhe tmerrohet nga plehurat që njerëzit e vet i hedhin vendit të tyre mbi fytyrë?! Së bashku t'i japim fund kësaj historie që na turpëron të gjithëve. Tani!", shkruan kryeministri Edi Rama në statusin e tij në FB.



TË BASHKOHEMI PËR TË SHKULUR NARKO-SHTETIN

"Nuk duhet të bëjmë kompromis me realitetin e hidhur që na serviren. Të lëmë mënjane ndasitë, të ngremë së bashku frymën e revoltës. Të bashkohemi në aksion politik për të shkullur nga rrënjët narko-shtetin. Shqipëria meriton më shumë, por kjo nuk arrihet vetëm për shkak të një grupi të caktuar. Nuk rresht së menduari se ky vend meriton më shumë. Disa mediokër po kërcënojnë nënat dhe vajzat shqiptare, Të shpëtojmë edhe kryeministrin tonë që është peng i krimet. Nëse Rama i do shqiptarët, të largohet dhe t'i lërë të qetë ata", shkruan kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi.



MARRËDHËNIA MBI GJENOCIDIN ME SERBINË

"Dënimi i gjeneral Ratko Mlladiqit me burg të përjetshëm për gjenocid dhe krime të tjera kundër njerëzimit është një obligim implicit për Serbinë që të ballafaqohet me të kaluarën. Arkitektura e marrëdhënies të tanishme brenda Bosnje e Hercegovinës dhe mes saj e Serbisë na njëra anë dhe Kosovës e Serbisë nga ana tjetër është e ndërtuar mbi gjenocidin dhe paafësinë e Serbisë për t'u ballafaquar me rolin e vet prijës në të", shkruan publicisti Veton Surroi në Facebook.



MEDIACitate

Me profesion është inxhinier, i shkolluar në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës, por që nga 19 nëntori është njëri nga deputetët më të rinj të Kuvendit të Kosovës, Qëndron Kastrati është edhe kryetari më i ri në moshë në tërë Kosovën. Madje duket se kryetar komune më të ri se Kastrati nuk ka edhe në rajon, kryesisht shkak i moshës së re e bën atë një "Sebastian Kurz të Kamenicës", por ndoshta edhe të Ballkanit. Kastrati është në fakt dy vjet më i ri se politikan austriak Sebastian Kurz, i cili në moshën 31-vjeçare u bë kancelar i Austrisë. Mirëpo Kurz nisi politikën edhe më herët se kaq. Ai qysh në moshën 27-vjeçare arriti ta drejtojë Ministrinë e Austrisë për Evropën, Integrimin dhe Punët e Jashtme, ndërsa ai 25-vjeçar, Kastrati u zgjodh deputet i Kuvendit të Prishtinës. shkruan tutje "Zëri".

(Gazeta Zëri, 23 nëntor)

Wolfgang Schäuble është një nga veteranët, nëse jo, veterani i politikës gjermane. Presidenti i Bundestagut nga radhët e CDU-së ka parë shumë dhe ka marrë pjesë në shumë betejat politike. Fjala e tij ka peshë. Të martën, Schäuble e përshkroi kështu në Parlament situatën pas dështimit të negociatave për koalicionin qeveritar në fundjavë: "Të dashur kolege dhe kolegë, aktualisht kemi një situatë të jashtëzakonshme, këtë e theksoi edhe Presidenti Federal. Është një test, por nuk është krizë shtetërore".

(DW, 23 nëntor)

Komisioneri i lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Zeid Ra'ad Al Hussein, përshëndeti aktgjykimin e Tribunalit të Hagës ndaj Ratko Mlladiq, ish-komandanti ushtarak i Ushtrisë së Republikës Serpska, duke e quajtur "fitore të rëndësishme për drejtësinë". Në një njoftim, i cili u publikua menjëherë pas shqiptimit të aktgjykimet, Al Hussein, tha se Mlladiçi është "personifikim i së keqes, ndërsa ndjekja penale ndaj Mlladiqit është personifikim i gjithçkaje që paraqet e drejta ndërkombëtare".


(Anadolu Agency, 23 nëntor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Sa vjeç kanë vdekur vëllezërit Frashëri?

Naim Frashëri lindi më 25 maj 1846 në Frashër të Përmetit dhe vdiq më 20 tetor 1900 në lagjen Erenqoj të Stambollit, ku edhe u varros. Eshtrat e tij janë sjellë në Shqipëri para viteve '90. Sami Frashëri lindi më 1 qershor 1850 në Frashër dhe vdiq më 18 qershor 1904 në Stamboll. Abdyli Frashëri lindi në vitin 1839 në fshatin Frashër dhe vdiq më 23 tetor të vitit 1892 në Stamboll. Pra kanë lindur të tre në Frashër dhe kanë vdekur të tre në Stamboll. Është kurioze që ndërruar jerë thaujse në të njëjtën moshë, Naimi në moshën 54 vjeçare, Samiu në

moshën 54 vjeçare dhe Abdyli në moshën 53 vjeçare. Figura më e njohur mbetet ajo e Naimit, por në fakt kanë qenë Abdyli dhe Samiu ata që e ndikuan fillimisht atë. Nën ndikimin e ngjarjeve historike, sidomos të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, njëri nga udhëheqësit e së cilës ishte Abdyli, dhe të veprimtarisë kulturore patriotike të Shoqërisë së Stambollit, në krye të së cilës ishte Samiu, Naim Frashëri braktisi vjershërimin persisht dhe iu kushtua letërsisë shqiptare. Poema e tij e parë e re ishte Shqipëria (1880, botuar më 1897), që



entuziazmoi patriotët shqiptarë. Në Stamboll Naim Frashëri ka qenë ndër botuesit kryesorë të "Revistës Dita", më pas "Dituria" (1884-1885), ku u botuan shumë vjersha të tij, proza e vargje për shkollat e para shqipe që do të hapeshin.

MBLEDHJE E PËRBASHKËT MAQEDONI-BULLARI NË STRUMICË

PA DILEMË ME BULLGARINË

Koha Zejnulla VESELI

Strumicë, 23 nëntor - Me nënshkrimin e Deklaratës së përbashkët në të cilën janë vlerësuar të gjitha angazhimet për avancim të bashkëpunimit në të gjitha sferat dhe me nënshkrimin e nëntë marrëveshjeve bilaterale, përfundoi mbledhja e parë e përbashkët e Qeverisë së Maqedonisë dhe asaj të Bullgarisë që u mbajt dje në Strumicë. Kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov, në konferencë të përbashkët për shtyp me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev, e theksoi mbështetjen ndaj Maqedonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

"Dëshiroj vetëm të them se pardje gjatë takimit me kryetarin e Parlamentit evropian, Tajani, së bashku me grupet parlamentare nga Parlamenti evropian në Sofje, thashë qartë se tani është momenti të shfrytëzohet kryesimi bullgar, pas atij austriak, rumun dhe kroat dhe për dy vite Ballkani Perëndimor mos jetë vetëm në vëmendjen e Brukselit, por të lëvizë realisht. Jam i bindur se për dy-tre muaj do të arrijmë ta ulim roamingun. Jam i bindur se edhe Korridorit 8 do të zhvillohet. Politika jonë është në politikën për bashkëngjitje në pjesën e ekonomisë, energjetikës sepse kjo sjell investime dhe të ardhura më të larta. Njerëzit dëshirojnë punë, të kenë të ardhura, të mund të udhëtojnë dhe të bëjnë biznes, ndërsa ne jemi të obliguar t'ua mundësojmë këtë", tha Borisov. Ai theksoi se konsideron që perspektiva e Maqedonisë në NATO është me rëndësi të madhe, dhe se si qeveri - do të vazhdojnë me një sërë veprimesh praktike. Në ndërkohë, kryeministri Zaev theksoi se deklarata e përbashkët është bazuar në frymën e transparencës dhe besimit, respektimit të ndërsjellë dhe mirëkuptimit me theksim të



"Nuk ekziston diçka që nuk jemi të aftë ta bëjmë më mirë se ajo që mendojmë se mundemi. Maqedonia dhe Bullgaria e bënë, qëndruam pranë njëra-tjetrës me Marrëveshjen e nënshkruar për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim...", tha Zaevi në konferencë të përbashkët për shtyp me kryeministrin bullgar, Bojko Borisov

rëndësisë së bashkëpunimit aktiv rajonal si bazë për stabilitet të qëndrueshëm në Evropën Juglindore.

"Nuk ekziston diçka që nuk jemi të aftë ta bëjmë më mirë se ajo që mendojmë se mundemi. Maqedonia dhe Bullgaria e bënë, qëndruam pranë njëra-tjetrës me Marrëveshjen e nënshkruar për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim, ndërsa me mbledhjen e sotme qeveritare aktivizuar edhe një nga motorët të cilët duhet ta tërheqin tërë rajonin përpara. Këtë vetëdije që e kemi si qeveri për përgjegjësinë tonë historike që hap perspektiva, është me rëndësi për marrëdhëniet tona bilaterale, për eurointegrimin e Maqedonisë dhe të rajonit", theksoi kryeministri Zaev. Ai shtoi se në mbledhjen e përbashkët janë konfirmuar sferat e interesit të përbashkët për zhvillim të përgjithshëm.

"Në mbledhjen e përbashkët biseduam për bashkëpunimin në ekonomi, energjetikë, infrastrukturë, do ta zhvillojmë bashkëpunimin tejkufitar, do të vazhdojmë me

proceset e nevojshme reformuese për integritet evropian dhe euroatlantike. T'i përforcojmë lidhjet tregtare dhe afariste. Promovuar udhëtim të turistëve nga vende të treta, përfshirë zhvillim të prodhimit të përbashkët turistik", tha Zaev. Ai theksoi se me kryeministrin bullgar Borisov biseduan për furnizim plotësues me gaz të dy vendeve, si dhe për realizimin e Korridorit 8 si prioritet kulmor i interesit të përbashkët.

"Një prej dëshirave më të mëdha është që me të vërtetë nga Shkupi të mos udhëtohet katër-pesë orë, por shumë më shpejt, kjo të mundësohet si alternativë përmes një autostrade të bukur ose hekurudhë të bukur. Ai është Korridorit, 8 i cili është një spektër i gjerë i mundësive për qytetarët nga i gjithë rajoni", tha Zaev. Sipas Borisovit, interesi që të financohet projekti është shumë i madh nga të gjithë sepse shohin se realisht mund të realizohet. Kjo, potencoi, të ndodhë me presion më të madh dhe financim të garantuar.

"Me kolegët të cilët do të vijmë do të shtrëngojmë duart kush ka nevojë për financim të shfrytëzohet mjete nga bankat dhe të shohim se çka do të japë Komisioni Evropian dhe mjete buxhetore gjithashtu. Më 6 dhe 7 dhjetor do të jemi një hap përpara", tha Borisov. Për linjën hekurudhore Shkup - Sofje në territorin e Bullgarisë janë të gatshme projektet dhe, siç tha Borisov, e dinë se sa do të kushtojë. Në territorin e Maqedonisë ende nuk janë siguruar të holla për aksin e tretë, nga Kriva Pallanka deri në kufirin me Bullgarinë. Siç informon Zaev, brenda gjashtë muajve duhet të krijohen kushte për hyrje në fuqi të memorandumit të nënshkruar sot për çmime të ulëta në roaming midis Maqedonisë dhe Bullgarisë. Kryeministri i Maqedonisë theksoi se para kryesimit të Bullgarisë me BE-në, Maqedonia e sendërtoi bashkëpunimin, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë në realizimin e proceseve reformuese dhe ndihmës nga përvojat dhe ekspertizat bullgare.

Këto janë marrëveshjet për bashkëpunim

- Ministrat e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska dhe Krasimir Karakaçanov nënshkruan Protokolli për bashkëpunim në trajnimet e zbatuara për pjesëtarët e ARM-së në shkollat ushtarake në Bullgari.

- Maqedonia dhe Bullgaria me memorandum e zyrtarizuan edhe paralajmërimin për uljen e tarifave ndërkombëtare për roaming në shërbimet e telekomunikimit. Dokumenti mundëson që trupat rregullatore të dy shteteve të fillojnë procedurë me të cilën do t'i nixtin operatorët të nënshkruajnë marrëveshje për çmime më të ulëta gjatë bisedave, porosive dhe internetit në roaming.

- Ministria bullgare e Turizmit, Nikolina Angelova dhe zëvendësministri i Maqedonisë i Ekonomisë, Kire Naumov, nënshkroi Marrëveshje për bashkëpunim në turizëm. Marrëveshja, mes të tjerash, parasheh bashkëpunim intensiv në turizëm, rritje të vizitave të ndërsjella turistike dhe pjesëmarrje të përbashkët në panaire turistike.

- Në Strumicë janë nënshkruar edhe marrëveshje për bashkëpunim me sektorin energjetik. Me to parashihet nga fillimi i vitit 2018 vendosja e tregut të përbashkët për sistemimin e kapaciteteve përçuese midis operatorëve elektroenergjetik të të dyja vendeve.

- Operatori bullgar për gaz "Bulgartranz" EAD dhe SHA Resurset energjetike të Maqedonisë - REM gjithashtu nënshkruan marrëveshje për zbatimin e studimit fizibilitiv për ndërtimin e lidhjes së re ndërsistimore të gazit.

- Agjencitë për kadastrë të të dyja vendeve, nënshkruan marrëveshje për këmbimin e materialeve kartografike dhe gjeodezike dhe informacioneve.

Mos u ngarkoni me historinë, harroni shtetet e "mëdha"

Nuk ka asgjë më të rëndësishme nga ajo që të kuptohemi me njëri-tjetrin. Mos u ngarkoni me histori, jetoni jetën, porositi kryeministri bullgar Bojko Borisov, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve pas seancën së sotme të përbashkët të qeverive të Maqedonisë dhe Bullgarisë. Ai theksoi se kemi histori mijëvjeçare dhe se secili mund të kontestojë dhe të pohojë se është më i moshuar, por që historianët duhet të merren me këtë. Me Zaevin, siç tha, dëshirojnë të zgjidhin çështje praktike. Historianët, theksoi ai, le të dësh-mohen se kush, se si dhe nga se ka dalë. "Nëse bëjmë bisedë të tillë, të konte-

stojmë se cila gjuhë çfarë është, ndërsa këtu Karakaçanov është shumë i përgatitur, në vend që ta nënshkruajmë marrëveshjen për bashkëpunim të përbashkët, në fund duhej që me zonjën (ministren e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska) këtu të vijmë me nga një tank", tha Borisov. Ai potencoi se në takimin e parë me Zaevin i ka thënë se duhet të harrojmë Shqipërinë e Madhe, Serbinë e Madhe, Bullgarinë e Madhe, Greqinë e Madhe, Maqedoninë e Madhe, sepse, theksoi, sa më të vegjël që jemi, aq më shpejt do të arrijmë që pagat dhe infrastrukturat t'i afrojmë me ato nga Ballkani Perëndimor.

Nuk përzihe mi në punën e kishës!

Si qeveri dhe si politikanë, e respektojmë karakterin sekular dhe nuk dëshirojmë të përzihe mi në punën dhe bashkëpunimin e dy kishave, por i inkurajojmë të gjendet zgjidhje në frymën e fqinjësisë së mirë dhe miqësisë, porositën kryeministri i Maqedonisë dhe ai i Bullgarisë, Zoran Zaev dhe Bojko Borisov nga Strumica. Lidhur me letërën që Kisha ortodokse e Maqedonisë - Arqipeshkopia e Ohrit e dërgoi deri te Kisha ortodokse bullgare, kryeministri Zaev tha se bëhet fjalë për çështje mes dy kishave, por se mund t'i inkurajojmë të gjejnë zgjidhje. "Unë shpresoj se do të vijë deri te njohja e ndërsjellë, pasi për ne si kishë ortodokse maqedonase - Arqipeshkopia e Ohrit, autoqefalia është shumë e rëndësishme. Çështja është mes dy kishave. E jona është t'i inkurajojmë të gjendet zgjidhje në frymën e Marrëveshjes për fqinjësi të mirë dhe miqësi mes dy vendeve", tha



Zaev, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve. Edhe kryeministri bullgar Borisov tha se nuk dëshirojnë të përzihen në punën e kishave, por se do të jenë të lumtur që dy kishat të bashkëpunojnë, siç bashkëpunojnë të dy shtetet në planin politik. "Nuk përzihe mi në punën e kishës. Me të vërtetë do të jemi të lumtur nëse kishat tona punojnë dhe në mënyrë të ndërsjellë ndihmohen mes vete, siç atë e bëjmë ne në planin politik", tha Borisov.

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE EVROPIANE MBLIDHET NGA MESI I DHJETORIT

KUNDËR NIVELIZIMIT TË SHQIPES ME GJUHËT E PAKICAVE

Dy partnerët shqiptarë të LSDM-së në Qeveri - BDI dhe Aleanca për Shqiptarët përjashtojnë çdo mundësi për ndërhyrje në draft-ligjin për gjuhët për të cilin thonë se kanë një marrëveshje politike si kusht për bashkëqeverisje

Koha Fatos RUSHITI



STRATEGJIA E BDI-SË PËR TEJKALIMIN E AMENDAMENTEVE TË LSDM-SË

Megjithatë, sipas burimeve të veta të afërta me partitë parlamentare, gazeta KOHA merr vesh se në Komisionin për çështje evropiane, deputetët shqiptarë nuk do t'u lënë hapësirë deputetëve të LSDM-së të vijjnë në rend ditë me amendamentet e tyre, duke i dhënë kështu përparësi amendamenteve të VMRO-së dhe Lëvizjes BESA, ndërsa për tre ditë sa do të zgjasë debati - kohën do ta harxhojnë me fjalime të gjata. Sipas këtyre burimeve, draft-ligji që është propozuar në Parlament nga Qeveria, për asnjë

presje pikë a fjalë tjetër nuk do të ndryshojë. Sipas Rregullores së Parlamentit, kur ligjet janë me shenjë e BE-së, nuk ka debat në komision më shumë se tre ditë, ndërsa debati në seancë plenare nuk është i kufizuar, por që këtu nuk mund të ndërhyhet me amendamente. Përveç nëse dramatizohet situata politike dhe partitë maqedonase - sidomos VMRO mund të përsërit atë që bëri me debatin për zgjedhjen e Qeverisë me fjalime, replika dhe kundër-replika mes vete.

për bashkëqeverisje. "Parlamenti duhet ta miratojë Ligjin e gjuhëve në formë ashtu siç propozuar, pasi është produkt i konsensusit politik si parakusht për formimin e koalicionit dhe Qeverisë", ka thënë deputeti i BDI-së, Artan Grubi, njëherësh kryetar i Komisionit për çështje evropiane. Ai ka paralajmëruar që të caktojë seancë diku nga mesi i dhjetorit me arsyetimin se për momentin - ka një agjendë tjetër të kryerjes së reformave në vend. "Vlerësoma se kjo javë është me rëndësi për çështje tjera reformue-

se dhe i dhashë kësaj përparësi, që të mos bëhet defokusim i opinionit nga ajo që për momentin është më me rëndësi dhe urgjente", ka thënë Grubi. Në ndërkohë, nga ASH janë kritik për zgjatjen e miratimit të Ligjit për gjuhët. "Ligji i përdorimit të gjuhës shqipe vlerësojmë se duhet të sillet sa më shpejt që është e mundur, pa stërzgjatje dhe taktizime të ndryshme, madje është shumë i vonuar, kur dihet se ka qenë ndër pikat kryesore të Marrëveshjes së Ohrit dhe si i tillë është inkorporuar në Kushtetutën e Ma-

qedonisë, ndërsa ka munguar një ligj adekuat për përdorimin e saj. Është shumë e vërtetë se ASH ka qenë aktive në përpilimin e këtij propozim-ligji, duke shfrytëzuar maksimalisht mundësitë kushtuese, për përdorim cilësor në tërë territorin e shtetit, si dhe në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike. Në jemi po ashtu propozuesit e këtij propozim-ligji", thotë Flakron Bexheti, anëtar i Kryesisë qendrore të ASH-së. Në lidhje me amendamentet e propozuar të LSDM-së dhe VMRO-së, ku kërkohet të hiqet fjala "gjuha shqipe", Bexheti thotë se ata deputetë që nuk duan ta nivelizojnë gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase, nuk kanë të drejtë as ta nivelizojnë gjuhën shqipe me gjuhët e pakicave në Maqedoni. "Sa u përket amendamenteve, mendojmë se shumica parlamentare duhet të jetë në mbrojtje të propozim-ligjit ashtu siç është. Ata deputetë apo parti politike, që nuk e lejojnë barazinë e plotë mes maqedonishtes dhe shqipes, nuk e kanë të drejtën ta nivelizojnë shqipen me gjuhët e

qendonisë, ndërsa ka munguar një ligj adekuat për përdorimin e saj. Është shumë e vërtetë se ASH ka qenë aktive në përpilimin e këtij propozim-ligji, duke shfrytëzuar maksimalisht mundësitë kushtuese, për përdorim cilësor në tërë territorin e shtetit, si dhe në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike. Në jemi po ashtu propozuesit e këtij propozim-ligji", thotë Flakron Bexheti, anëtar i Kryesisë qendrore të ASH-së. Në lidhje me amendamentet e propozuar të LSDM-së dhe VMRO-së, ku kërkohet të hiqet fjala "gjuha shqipe", Bexheti thotë se ata deputetë që nuk duan ta nivelizojnë gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase, nuk kanë të drejtë as ta nivelizojnë gjuhën shqipe me gjuhët e pakicave në Maqedoni. "Sa u përket amendamenteve, mendojmë se shumica parlamentare duhet të jetë në mbrojtje të propozim-ligjit ashtu siç është. Ata deputetë apo parti politike, që nuk e lejojnë barazinë e plotë mes maqedonishtes dhe shqipes, nuk e kanë të drejtën ta nivelizojnë shqipen me gjuhët e



FLAKRON BEXHETI

Sa u përket amendamenteve, mendojmë se shumica parlamentare duhet të jetë në mbrojtje të propozim-ligjit ashtu siç është. Ata deputetë apo parti politike, që nuk e lejojnë barazinë e plotë mes maqedonishtes dhe shqipes, nuk e kanë të drejtën ta nivelizojnë shqipen me gjuhët e tjera të komuniteteve më të vogla si me turqishten, serbishten, gjuhën rome...



ARTAN GRUBI

Parlamenti duhet ta miratojë Ligjin e gjuhëve në formë ashtu siç propozuar, pasi është produkt i konsensusit politik si parakusht për formimin e koalicionit dhe Qeverisë

tjera të komuniteteve më të vogla si me turqishten, serbishten, gjuhën rome...", këmbëngulë Bexheti i ASH-së. Deputeti i VMRO-së, Dragan Danev të enjten ka përsëritur kërkesën e partisë së tij për ligjin e gjuhëve. "Bazuar në shkeljet që ka bërë propozuesi i Ligjit dhe atë që deklaroi komisar Han, Ligji duhet të sillet me procedurë të rregullt dhe të hapet debat me ekspertë dhe komisioni amë të jetë Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis komuniteteve. VMRO-DPMNE edhe si pushtet edhe si opozitë tani, gjithnjë ka qenë konstruktive dhe në interes të qytetarëve të Maqedonisë. Por kur nga ne kërkohet të jemi konstruktiv pranë gjitha këtyre shkeljeve të Rregullores, të procedurave, por edhe të Kushtetutës së vendit, atëherë një konstruktivitet të tillë nga ne si VMRO mos e prisni", deklaroi Danev.

ME KE-NË, I ZGJIDHIM TË GJITHA DILEMAT DHE ÇËSHTJET

Qeveria ka komunikim të përditshëm të hapur në të gjitha nivelet me Komisionin Evropian. Zgjidhen dilema dhe çështje, sinqerisht dhe drejtpërdrejt. Në fakt, janë realizuar shumë hapa reformues që shihet edhe nga deklarata e eurokomisarit Johannes Han në Shkup. Fokusi deri në fund të vitit do të jetë në zbatimin e planifikimeve, thonë nga MPJ-ja për MIA-n lidhur me akuzat në disa media se Brukseli dërgoi kritikën e parë të hapura për Qeverinë e Maqedonisë. Sipas tyre, Komisioni Evropian, nëpërmjet Ambasadës së Maqedonisë në Bruksel nga



Qeveria e re ka kërkuar realizim të reformave urgjente nga Plani 3-6-9. Komisioni thotë se qeveria e Zoran Zaevit u ka kushtuar shumë vëmendje marrëdhënieve me publikun në vend të reformave. Brukseli pret t'i shohë rezultatet e para reformuese deri në mes të janarit. Komisioni Evropian e ka paralajmëruar Qeverinë se do të ketë pasoja negative nëse ndikohet ndaj ndryshimeve në ligjet nga pakaja për reforma mediatike, fushë që nuk është në prioritetet e BE-së. Vërejtjet gjithashtu kanë të bëjnë edhe me reformat në DSK dhe gjyqësi.

"SOPOTI" PROLONGOHET PËR 20 DHJETOR



GJYKATA ME STANDARDE TË DYFISHTA

Të pranishmit në seancën gjyqësore për lëndën "Shuplakat", ashtu siç ishte rasti me "Sopotin", nuk patën mundësi të dëgjojnë qëndrimin e Trupit gjykues, se si mundet që një person, pjesë e lëndës gjyqësore - të gjykohet përderisa identiteti i tij nuk është i vërtetuar me dokument, ashtu sikurse i kërkoi dëshmitarit kryesor për Sopotin, Ramadan Bajrami

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 23 nëntor - Mbarimi i afatit të letërnjoftimit i dëshmitarit kryesor në rastin e "Sopotit", Ramadan Bajramit, të enjten i pamundësoi dhënien e dëshmisë para Trupit gjykues në Gjykatën Penale të Shkupit dhe me këtë, edhe u anulua seanca gjyqësore për më 20 dhjetor. Këshilli Penal i kësaj gjykate, i kryesuar nga gjykatësja Dijana Gruevska Ilievska, vërtetoi se dokumenti i identifikimit i dëshmitarit të propozuar nga pala mbrojtëse është i pavlefshëm, për shkak se e drejta e shfrytëzimit i kishte mbaruar tre muaj më parë. Përveç letërnjoftimit, i cili nga Ministria e Punëve të Brendshme, dëshmitarit Ramadan Bajramit, i cili ishte ndarë në vitin 2002, ai shtoi se posedon edhe pasaportë, megjithatë të njëjtën nuk e mban me vete. "Në këso rrethana, kur një dokument identifikimi është i dhënë 15 vite më herët, gjegjësisht edhe fotografia shihet se është e vjetruar, ne nuk mundemi me saktësi të konstatojmë identitetin e dëshmitarit", tha gjykatësja, Gruevska Ilievska.

Mirëpo, ky Trup gjykues - me ose pa vetëdije, nuk e mori parasysh praktikën gjyqësore e cila u vendos ditë më parë. Një situatë e ngjashme, në Gjykatën Penale të Shkupit ndodhi në procesin gjyqësor "Shuplakat", ku mes tjerash - me akuzë ngarkohet edhe ish-ministri i Transportit, Mile Janakieski. Me datë 20 nëntor, në po të njëjtën Gjykatë, Trupi gjykues i drejtuar nga Tatjana Mihajlovska, e zhvillonte seancën gjyqësore për dhunën e ushtruar në Komunën Qendër, në qershor të vitit 2013. Gjatë fillimit të seancës, gjykatësja Mihajlovska e lexoi emrin e të akuzuarit Mile Janakieski, prej të cilit kërkoi që të vërtetojë identitetin e tij me letërnjoftim. Por, përgjigja e ish-ministri të Transportit ishte se "nuk e posedon letërnjoftimin e as

ndonjë dokument tjetër identifikimi (pasaportën tha se e ka të konfiskuar nga vetë gjykata)". Opinioni prezent në seancën gjyqësore për lëndën "Shuplakat", ashtu siç ishte rasti me "Sopotin", nuk pati mundësi të dëgjoj qëndrimin e Trupit gjykues, se si mundet që një person, pjesë e lëndës gjyqësore, të gjykohet përderisa identiteti i tij nuk është i vërtetuar me dokument, ashtu sikurse ndodhi me dëshmitarin e rastit të Sopotit. Pala mbrojtëse e të akuzuarve në rastin e "Sopotit", proces ky i cili javë më parë filloi nga fillimi, pasi lëndën e mori përsipër Prokuroria Speciale Publike, tha se gjykimi kundër klientëve të tyre u zhvillua deri në një moment kur gjykata vërtetoi se dëshmitari nuk posedon dokument të vlefshëm të identitetit. "Përndryshe, këtë seancë e karakterizoi shqyrtimi i deklaratave të dhëna paraprakisht nga dëshmitarë tjerë, mes tjerave dhe ish-deputeti Hajrullah Misimi, i cili ka qenë edhe kryetar i Komisioni parlamentar anketues, komision që edhe konstatoi të gjitha lëshimet që janë bërë nga

PRANOHEM AKTAKUZA PËR RASTIN "TOPLIK"
Gjykata Themelore Shkup e pranoi aktakuzën për rastin "Toplik" të Prokurorisë Speciale Publike. Në "Toplik" janë të dyshuar gjashtë persona, në mesin e të cilëve edhe ish ministri i Transportit dhe Lidhjeve Mile Janakieski për shitjen e parcelës ndërtime për ndërtimin e lagjes "Qyteti i Diellit" në Sopisht të Shkupit. Për "Toplik" regjistrimet nga bisedat e përgjuara janë pranuar si prova.

Arrestimi, ngritja e aktakuzës dhe marrja e deklaratave me dhunë nga dëshmitarët për rastin "Sopotin", ka ndodhur në kohën kur me policinë sekrete ka udhëhequr këshilltari aktual për siguri i kryeministrit Zoran Zaev, ish-drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Zoran Verushevski



ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjatë trajtimit të dëshmitarit kryesor. Pasi dëshmitari Ramadan Bajrami, më 20 dhjetor ta japë deklaratën e tij para Trupit gjykues, ne si palë mbrojtëse duhet të prononcohemi lidhur me dëshmitë tjera materiale të propozuara nga PSP-ja", tha avokati Vullnet Paçuku. Propozimi i parashtruar nga PSP deri te Gjykata, në seancën e fundi të mbajtur për këtë rast, ishte që në seancë gjyqësore si dëshmitar të ftohen edhe pjesëtarët e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, institucion ky i cili ka pasur rol të rëndësishëm në zbardhjen e rastit të vendosjes së minës në fshatin Sopot të Kumanovës në vitin 2003, si pasojë e të cilës vdiqën dy ushtarë polak dhe një përktihyes maqedonas. Avokati Paçuku, po ashtu shtoi se inspektorët e lartë të policisë kanë dhënë dëshmitë e tyre në PSP, dhe pas prezantimit të tyre në seancë gjyqësore, ai pret që i gjithë procesi të zbardhet në tërësi. Ndryshe, arrestimi, ngritja e aktakuzës dhe marrja e deklaratave me dhunë nga dëshmitarët për rastin "Sopotin", ka ndodhur në kohën kur me policinë sekrete ka udhëhequr këshilltari aktual për siguri i kryeministrit Zoran Zaev, ish-drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Zoran Verushevski.

JANEVA PRET DËNIM TË RREPTË PËR MIJALKOVIN

Debati kryesor për lëndën e Prokurorisë Speciale Publike "Target-Fortesa" është caktuar për më 22 dhjetor, bëri të ditur Gjykata Themelore Shkup 1. Aktgjykimi i parë i plotfuqishëm për lëndën që e udhëheq PSP ishte shqiptuar dje, dënim me kusht prej gjashtë muajve mori njëri nga të akuzuarit për lëndën "Target-Fortesa", i cili në procedurën me vetëiniciativë e pranoi fajin e tij. PSP bëri të

ditur se në këtë lëndë është ndarë procedura penale për personin e dënuar, identiteti i të cilit nuk bëhet e ditur, ndërsa për të cilën, në bazë të pranimit të fajësisë, është sjellë aktgjykim më 17 nëntor. Prokurorja speciale publike, Katica Janeva, ndërkohë ka thënë se pret dënim më të rrepta për ish drejtorin e DSK-së, Sasho Mijalkov dhe ish shefin e Drejtorisë së Pestë, Goran Grujevski, të akuzuar në lëndën "Target-Fortesa".



KRONIKË

Lëndohet rëndë tetovari, bie nga çatia

Të mërkurën, rreth orës 10, në Spitalin Klinik të Tetovës është sjellë 27 vjeçari nga Tetova me initiale P.R, me thyerje në shpatullën e majtë dhe disa brinjë. Pas marrjes së ndihmës së parë, tetovari është transferuar në Klinikat e Shkupit si rast urgjent. Sipas informacioneve, 27 vjeçari lëndimet i ka marrë gjatë rënies nga çatia e shtëpisë së tij në rrugën "Jordan Zlatanovski" në Tetovë, ku së bashku me babin e tij kanë qenë duke punuar. Sipas policisë, dyshohet se për shkak të pakujdesisë, ai ka rënë në oborrin e improvizuar të shtëpisë në një lartësi prej 10 metrave. Menjëherë kanë vrapuar të afërmit, gjegjësisht babi dhe një shoku i tij, e kanë marrë me veturë dhe e kanë dërguar në spital. Pak kohë më pas, është kryer hetim dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

"Nasir Turs" aksidentohet në Austri, lëndohet shoferi

Shoferi i një autobusi nga Maqedonia është lënduar në një aksident rrugor gjatë përplasjes me një makinë që ka ndodhur mbrëmë rreth orës 22 në afërsi të Shlierbahut në Austri. Bëhet fjalë për autobusin e transportuesit nga Maqedonia "Nasir Turs" i cili ka qarkulluar nga Hamburgu për në Maqedoni. Për MIA-n, nga "Nasir Turs" konfirmuan se shoferi 40 vjeçar ka marrë lëndime dhe është transferuar në një spital austriak. Në momentin e aksidentit në autobus janë transportuar 28 udhëtarë, të cilët nuk janë lënduar dhe kanë vazhduar rrugën me autobus tjetër. Në aksidentin krahas autobusit kanë marrë pjesë edhe tre makina. Sipas mediave lokale, në aksident ka humbur jetën shoqëruesi në makinë një burrë 25 vjeçar, shoferi i makinës është lënduar rëndë, ndërsa janë lënduar më lehtë edhe tre persona. Sipas njohurive të para të policisë, deri te aksidenti ka ardhur kur makina ka kaluar në anën e kundërt dhe drejtpërdrejt është përplasur me autobusin.

Me thikë një të miture i vidhet celulari

Një shkupjan dyzet e katërvjeçar Z.S dje në polici ka denoncuar se më 21 nëntor rreth orës 20:30 në rrugën "Luka Gerov" në Shkup, disa persona të panjohur kanë kryer plaçkitje ndaj vajzës e tij 17 vjeçare. "MPB informon se e mitura ka lëvizur drejt stacionit të autobusëve dhe është hasur nga personat, me ç'rast njëri prej tyre ka nxjerrë thikën dhe me kërcënim ia ka marrë celularin dhe më pas janë larguar nga vendi i ngjarjes. Po ndërmerren masa për ndriçimin e plotë të rastit. (O.XH)

ASNJË PROPOZIM ZYRTAR PËR NDRYSHIME NË ÇMIMET SHETËRORE

Mungesa e vëmendjes shtetërore gjatë gjithë këtyre viteve, duke filluar me restaurimet sipërfaqësore të objektit, fondet minimale që i janë akorduar nga Ministria e Kulturës, zvarritja prej një dekade e çështjes së pronësisë... do të duhej që të paktën të kompensohej me insistimin që kjo datë e rëndësishme për kulturën dhe arsimin të ishte pjesë e çmimeve shtetërore



SKENDER HASANI

Edhe si Institut, edhe si Shoqatë e historianëve ne kemi folur për këtë çështje, që të ketë një çmim të tillë, për arritje në kulturë, shkencë, arsim, në mënyrë që të rritet edhe pesha e kësaj feste dhe kjo datë të zërë një vend të merituar. Besojmë se porosia jonë është marrë nga institucionet shtetërore dhe presim që të shoqërohet me iniciativë në Parlament për ndarjen e një çmimi të tillë

22 NËNTORI, NJË GJYSMË FESTË QË MERITON TË BËHET "11 TETORI"

Koha

Evis HALILI

Shkup, 23 nëntor - Nëse për vitin e ardhshëm përgatitjet për shënimin e 110 vjetorit të Kongresit të Manastirit do të kufizohen vetëm në programe festive, spektakle dhe tribuna shkencore, 22 nëntori do të mbesë thjesht një datë në kalendarin e festave shtetërore, një gjysmë festë dhe ditë pushimi për shqiptarët. Mungesa e vëmendjes shtetërore gjatë gjithë këtyre viteve, duke filluar me restaurimet sipërfaqësore të objektit, fondet minimale që i janë akorduar nga Ministria e Kulturës, zvarritja prej një dekade e çështjes së pronësisë, mbrojtja adekuate e objektit pas tentativave për ta djegur, varret e harruara të Qiriazëve... e të tjera, do të duhej që të paktën të kompensohej me insistimin që kjo datë e rëndësishme për kulturën dhe arsimin të ishte pjesë e çmimeve shtetërore, si çmimi "22 Nëntori", apo edhe çmimi "Parashqevi Qiriazit", apo "Gjerasim Qiriazit". Edhe pse për momentin nuk ka asnjë sinjal, apo kërkesë zyrtare nga pjesa shqiptare, lista e çmimeve shtetërore vazhdon të mbetet e njëjtë - monoetnike, diskriminuese, ndërsa debatet dhe propozimet që qarkullojnë kohët e fundit lidhen më shumë me data të tilla si "23 Tetori", ditën e Luftës revolucionare, apo ajo e VMRO-së. Një prej themeluesve të Institutit të Trashëgimisë, Xhabir Ahmeti, thotë se kjo datë duhet të shoqërohet me të paktën një çmim të rangut të çmimit shtetëror "11 Tetori" për vet faktin se vetë ngjarja - Kongresi i Manastirit, është një moment madhështor, është vula e cila i vihet faqes së shenjtërit të gjuhës sonë, e kësaj gjuhe që përfundimisht u hapi dyert institucioneve arsimore e kulturore kombëtare dhe religjioze të shqiptarëve, e kësaj gjuhe që i bashkon shqiptarët gjithandëj ku janë dhe çfarë do feje që i përkasin, e kësaj gjuhe që u bë atdheu pa kufij politik për ne shqiptarët. "Ajo që neve na e nxiti, na e ndez dhe na e ruan fuqishëm

ÇMIMET SHETËRORE

"11 Tetori" jepet nga Ministria e Kulturës dhe është çmimi më i rëndësishëm. I dyti është "Shën Klimenti i Ohrit" (Ministria e Kulturës), "Goce Dellçev" (Ministria e Arsimit), "Mito Haxhi Vasiliev Jasmin" (Ministria e Kulturës), "23 Tetori" (Ministria e Kulturës), "Nënë Tereza" (Ministria e Kulturës), "8 Shtatori" (Agjencia e të Rinjve dhe Sportit)

dashurinë për gjuhën shqipe, nuk është vetëm kontakti i parë që kemi pasur me fjalën shqipe të shqiptuar butë e ëmbël nga nëna. Natyrisht ky është faktori i parë, mirëpo është edhe diçka tjetër shekullore, është procesi i kalimit nëpër shekujt e shumtë të robërisë në të cilët gjuha shqipe e martirizuar, e shtypur, e përgjakur, e fyer dhe e poshtëruar skajshëmish nga okupatorët e ndryshëm, ia doli të mbrohet dhe ta kurorezojë rezistencën dhe krenarinë e popullit shqiptar me Kongresin e Manastirit, ku u vendos që shqipja të shkruhet me alfabetin latin, me një alfabet latin, me të cilin shërbehen të gjithë popujt perëndimorë. Kjo ngjarje që u mbajt në territorin e Maqedonisë së sotme duhet të bëhet festë për të

gjithë qytetarët e Maqedonisë. E jo vetëm kaq. Në këto kohë, kur Qeveria e re po tregon shenja mirëkuptimi dhe tolerancë më të madhe se të gjitha qeveritë e mëparshme për kulturën shqiptare, medoemos duhet që të jepet një çmim nacional i rangut të '11 Tetorit' për arritje e suksese të veçanta në fushë të kulturës dhe të arsimit, çmim të cilin do të mund ta marrin të gjithë punonjësit e dijes dhe të arteve që korrin suksese në punën e tyre", thotë Ahmeti. Sipas tij, faktori politik shqiptar përfundimisht duhet ta dëshmojë veten duke e nxitur realizimin e kësaj ideje sa më shpejt, sepse në mos sot, nesër kjo ide do të realizohet, sepse shqiptarët këtu janë realitet dhe askush më nuk do të mund t'i fshehtë pas dere as shqiptarët dhe as gjuhën shqipe, por do të detyrohet t'i respektojë njësoj siç i respektojnë shqiptarët fqinjët e tyre.

"Edhe si Institut, edhe si Shoqatë e historianëve ne kemi folur për këtë çështje, që të ketë një çmim të tillë, për arritje në kulturë, shkencë, arsim, në mënyrë që të rritet edhe pesha e kësaj feste dhe kjo datë të zërë një vend të merituar. Besojmë se porosia jonë është marrë nga institucionet shtetërore dhe presim që të shoqërohet me iniciativë në Parlament për ndarjen e një çmimi të tillë", thotë Skender Hasani, drejtori i Institutit të Trashëgimisë dhe kryetari i Shoqatës së Historianëve. Deri tani s'ka pasur asnjë kërkesë zyrtare,



XHABIR AHMETI

Në këto kohë, kur Qeveria e re po tregon shenja mirëkuptimi dhe tolerancë më të madhe se të gjitha qeveritë e mëparshme për kulturën shqiptare, medoemos duhet që të jepet një çmim nacional i rangut të '11 Tetorit' për arritje e suksese të veçanta në fushë të kulturës dhe të arsimit, çmim të cilin do të mund ta marrin të gjithë punonjësit e dijes dhe të arteve që korrin suksese në punën e tyre

madje edhe për ndryshimin e përbërjes së çmimeve shtetërore, apo edhe rikategorizimin e tyre. Ndryshimet e fundit në Ligjin për çmimet shtetërore që akordohen një apo disa herë në vit për kontribut dhe merita të veçanta në sfera të ndryshme janë bërë pesë vite më parë, por pa ndryshuar profilin monoetnik të tyre, me një përjashtim, çmimin "Nënë Tereza". "11 Tetori" jepet nga Ministria e Kulturës dhe është çmimi më i rëndësishëm. I dyti është "Shën Klimenti i Ohrit" (Ministria e Kulturës), "Goce Dellçev" (Ministria e Arsimit), "Mito Haxhi Vasiliev Jasmin" (Ministria e Kulturës), "23 Tetori" (Ministria e Kulturës), "Nënë Tereza" (Ministria e Kulturës), "8 Shtatori" (Agjencia e të Rinjve dhe Sportit).

PARASHQEVI QIRIAZI, DISKRIMINIMI NË SILIKON

Dhoma përkujtimore, një prej investimeve më të mëdha shtetërore që janë bërë deri tani për Muzeun e Alfabetit, me 11 figurat në silikon të anëtarëve të komisionit që drejtohej nga Gjergj Fishta është një tjetër neglizhencë ndaj kësaj date dhe një prej familjeve që dhanë kontributin e saj maksimal për Kongresin, dhe gjuhën e arsimit shqip, atë të Qiriazëve. Kompozimit në silikon, që bazohet tek një fotografi e asaj kohe nga Kel Marubi, dhe shumë pak në fiksimin e plotë të një momenti historik për shqiptarët ka anashkaluar një prej personazheve që luajti një rol të



rëndësishëm në atë periudhë, atë të Parashqevi Qiriazit, që jo vetëm lindi në atë qytet, por ishte pjesëmarrëse e Kongresit të Manastirit, sekretare e komisionit dhe më pas edhe autore e abetares së pare shqipe me alfabetin e Manastirit dhe e himnit të tij, por edhe autorja e parë femër e një projekti arsimor. Paradoksalisht Parashqevi Qiriazit mungon. Kjo mungesë shpreh shembullin më të keq të historisë që rrefen një muze, bazuar në fotografi dhe shumë pak në dokumente. Por edhe të diskriminimit gjinor, të një gruaje të rrallë që "eklipsohet" nga 11 burra.



Kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet që prej inaugurimit të godinës së Alfabetit dhe shpalljes shtëpi përkujtimore e më pas edhe si institucion nacional muze, por numri i punonjësve nuk ka ndryshuar shumë. Për momentin numërohen gjithsej gjashtë të punësuar së bashku me drejtorin

FERMERËT KUNDËRSHTOJNË PAGESËN

Sipas nënkryetarit të Federatës së Fermerëve të Maqedonisë, Memet Sinani, fermerët vite me radhë ballafaqohen me problemin e ekzistencës dhe mbijetesës së tyre në treg, andaj çdo pagesë shtesë e rëndon dhe nuk e lehtëson pozitën e tyre

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 23 nëntor - Bujqit janë kundër vendosjes së tatimit të ri në të ardhura, që pritet të funksionojë në vitin 2018. Me ndryshimet ligjore që janë në procedurë kuvendore, parashikohet që personat që nga kopshtet e tyre ju shesin prodhimet bujqësore restoranteve dhe personave të tjerë juridik, të paguajnë tatim shtesë. Deri tani ata ishin të liruar nga pagesa e tatimit nëse kishin të ardhura deri në 300 mijë denarë. Tani në shumën duhet të paguajnë 2 për qind tatim, ose 6000 denarë, për shkak se tatimohet vetëm 20 për qind e të ardhurave të realizuara, ndërsa pjesa e tjetër pranohet si harxhim gjatë prodhimit.

Nga Federata e Fermerëve të Maqedonisë kundërshtojnë një pagesë të tillë, për shkak të pozitës edhe ashtu të rënduar financiare të bujqve, që luftojnë për mbijetesë dhe për çdo denarë. Sipas nënkryetarit të Federatës së Fermerëve të Maqedonisë, Memet Sinani, fermerët vite me radhë ballafaqohen me problemin e ekzistencës dhe mbijetesës së tyre në treg, andaj çdo pagesë shtesë e rëndon dhe nuk e lehtëson pozitën e tyre.

"Edhe pse në shikim të parë duket se shuma prej 100 euro apo 6000 denarë që duhet ta paguajnë bujqit nuk është e madhe, megjithatë duhet thënë se fermerët ballafaqohen me problemin e rritjes prej tre denarë të akcizës së

naftës, me problemin e madh të shitjes së sigurt dhe pagesës me kohë të mundit të tyre që di të vnohet me muaj, por edhe një vit, me financimin e korrjeve dhe mbjelljeve, shtrenjtimin e të gjitha repromaterialeve nga njëra anë dhe çmimeve në stagnim apo edhe ulje të çmimeve të shitblerjes së shumicës së prodhimeve bujqësore apo blektorale. Pra, një pagesë e tillë edhe prej 6000 denarë, për bujqit është ngarkesë e madhe, andaj ne si Federatë e Fermerëve të Maqedonisë, do të kërkojmë edhe zyrtarisht anulimin e kësaj mase nga ana e Ministrisë së Financave, në të kundërtën mund të pritet edhe protesta dhe bllokada të rrugëve nga ana e fermerëve", thotë Sinani.

Sipas tij, nevojitet që të propozohen më shumë masa lehtësuese dhe mbështetëse për bujqit, me qëllim të rritjes së interesimit të rinjve që të merren me bujqësi apo blegtori, për shkak se në vitet e fundit kemi një interesim shumë të vogël nga ana e tyre që të jetojnë nga kjo veprimtari, si rrjedhojë e fitimit jo të kënaqshëm nga bujqësia. Me ndryshimet e reja ligjore, parashikohet që personat që shesin prodhime bujqësore, të paguajnë

tatim personal në të hollat që i kanë fituar përkundër sasive që i kanë shitur. Ndër të tjera, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për tatim personal, propozohet që tatimin në emër të tyre për prodhuesit më të mëdhenj, ta paguajë kompania grumbulluese e prodhimeve bujqësore, ndërsa ata që realizojnë të ardhura deri në një milion denarë, do të duhet të regjistrohen. Propozohet që personat që gjatë vitit realizojnë të ardhura nga shitja e prodhimeve vetanake bujqësore deri në një milion denarë, të paguajnë tatimin personal në të ardhura pas refuzimeve. Kjo nënkupton se në emër të tyre tatimin do ta paguajnë personat juridik që ju paguajnë të ardhurat që do të kenë obligim të përlllogarisin dhe paguajnë tatimin personal në të ardhura.

Baza për përlllogaritjen e tatimit paraqet diferenca në të ardhurat e përgjithshme dhe harxhimet e pranuar deri në 80 për qind që nënkupton se do të tatimohen 20 për qind e të ardhurave të realizuara theksohet në ndryshimit dhe plotësimet ligjore. Përcaktohet edhe obligimi që bujqit, të cilët gjatë një vit shënojnë të ardhura



MEMET SINANI

Një pagesë e tillë edhe prej 6000 denarë, për bujqit është ngarkesë e madhe, andaj ne si Federatë e Fermerëve të Maqedonisë, do të kërkojmë edhe zyrtarisht anulimin e kësaj mase nga ana e Ministrisë së Financave, në të kundërtën mund të pritet edhe protesta dhe bllokada të rrugëve nga ana e fermerëve

nga shitja e prodhimeve vetanake bujqësore më të larta se një milion denarë, pas skadimit të vitit, dhe atë më së voni deri më 15 janar, të regjistrojnë edhe zyrtarisht veprimtarinë e tyre ekonomike.

Deri tani personat që realizojnë të ardhura nga bujqësia deri në një milion e 300 mijë denarë, paguan tatim personal në të ardhura sipas paushalit të vendosur nga Drejtoria për të Ardhura Publike dhe kishin obligim që për çdo vjet deri te DAP, të parashitrojnë kërkesë për të drejtën e një tatimi të tillë. Personat me të ardhura nga bujqësia si profesion primar deri më 300 mijë denarë ishin të liruar nga tatimi, ndërsa ata me të ardhura mbi 1 milion e 300 mijë denarë, kishin obligim ligjor të regjistrohen për kryerjen e veprimtarisë në bazë të ligjit. Gjithashtu, personat që realizojnë të ardhura nga shitja e prodhimeve vetanake në vendet e shitjes në tregjet e gjelbra, do të tatimohen në bazë të paushalit të të ardhurave neto me vendimin e DAP. Edhe deri tani kjo kategori i personave tatimohet me paushal, ndërsa me ndryshimet e fundit, e njëjta problematikë rregullohet me nen të veçantë.

Ganiu priti ambasadorin Hysa



Shkup, 23 nëntor - Kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, të enjten priti ambasadorin e Republikës së Kosovës, z. Ylber Hysa, me të cilin biseduan rreth gjendjes aktuale në Komunën e Çairit, sfida të saja në mandatin e ri katër vjeçar dhe shprehën përkushtimin e plotë për vazhdimin e bashkëpunimit në procesin e realizimit të reformave zhvillimore. Kreu i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, njoftoi ambasadorin Hysa me projek-

tet e premtuara në programin "Kontrata 2017-2021" dhe hapat e para të ndërmarra në këtë drejtim. Gjatë takimit u bisedua edhe për nevojën e vazhdimësisë së bashkëpunimit me komunat e Republikës së Kosovës në sferën e arsimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik. Ambasadori Hysa uroi punë të mbarë dhe shprehu përkrahjen e plotë për dinamikë sa më efikase në realizimin e projekteve të raportara.

FMN nuk kërkon rritje të kufirit të moshës për pensionim

Shkup, 23 nëntor - Qeveria e mori me seriozitet stabilizimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor dhe menjëherë formuam Këshill qeveritar të cilin e udhëheq Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ku bëjnë pjesë katër ministra, jemi duke diskutuar për gjendjet në FSPI dhe dy ekspertë të Bankës Botërore janë duke punuar në analizat e detajuara të shoqërive pensionale, MAPAS dhe Fondit të SPIM dhe së shpejti presim raport prej të cilit do të dalë Plani veprues për ndryshimet ligjore dhe rregullativën, deklaroi ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska. E pyetur nëse do t'i pranojnë rekomandimet e FMN-së për stabilizimin e SPIM, Carovska tha se i respektojnë rekomandimet, por

rekomentimet e tyre nuk janë që të hiqet stazhi me beneficion dhe nuk janë që të rritet kufiri i moshës. "Në Maqedoni ekzistojnë hapa të tjerë të cilët duhet të ndërmerren dhe për këtë do të dalim kur të kemi plan të detajuar. Që të mund të stabilizohet Fondit, gjënë e parë të cilën e ndërmoren është se e respektojmë vendimin ligjor për rritjen e pensioneve dhe harmonizimin, ndërsa jo ad hock rritje paushale që të cilat nuk ka baza", deklaroi Carovska. Ajo theksoi se është shumë e rëndësishme se Qeveria në mënyrë të përgjegjshme pohon se do të kujdeset për pensionistëve aktual, por edhe për pension dinjitoz

të pensionistëve të ardhshëm që është diskutim të cilin do ta hapim bashkërisht dhe do të diskutojmë. "Nuk është vendimi i vetëm rritja e kufirit të moshës. Ky është vendimi i fundit i cili duhet të ndërmerret, me të vërtetë në Maqedoni ka gjëra të tjera të cilat duhet të tejkalohen në sistem. Tani kemi masa të tjera të cilat do t'i ndërmerrem dhe do të bëhen publike", deklaroi Carovska.



RRJETET SOCIALE NDËR SHKAQET MODERNE TË DIVORCIT



Me rritjen e përdorimit të rrjeteve sociale, po rritet edhe numri i divorceve. Sociologët alarmojnë se çifteve të reja, para se të vendosin për kurorë, në shumë raste u nevojitet edukim

PËR TETË VJET, MBI 15 MIJË DIVORCE

Aida XHONI

Shkup, 23 nëntor - Gjatë tetë viteve të fundit, në Maqedoni kanë ndodhur 112.985 martesë, ndërsa po në këtë periudhë - 15.117 martesë kanë dështuar. Këto janë të dhënat të cilat i ka grumbulluar gazeta KOHA nga periudha prej vitit 2009 deri në vitin 2016 e që ka konsultuar të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror për Statistikë (ESHS). Sociologu Rezak Jakupi, profesor universitar në Kolegjin ISPE në Prishtinë dhe profesor i sociologjisë në gjimnazin e Gostivarit, thotë se shtimi i divorceve, në kushtet e një shoqërie moderne, konsiderohet si dukuri sociale me përmasa universale dhe pasoja tepër të rënda për shoqërinë. I cilësuar në disa raste si zgjidhja e vetme për një familje jofunksionale nga një martesë e dështuar, Jakupi thotë se divorci pranohet botërisht se është shkatërrimi përfundimtar i një lidhjeje martesore me pasoja negative për çiftin, por mbi të gjitha për fëmijët. "Ndër shkaqet më të rëndësishme që zakonisht në territoret ku jetojmë ne dhe në rajon më gjerë - janë rrethanat ekonomike, përshtetimi i dinamikës së jetës të përditshme, mungesa e pavarësisë së vetë personave që vendosin të jetojnë së bashku apo të lidhin martesë, mos ekuilibrimi i asaj se martesë është një përgjegjësi e madhe, ku njëkohësisht edhe divorci ka pasojat e veta. Shpeshherë në këto rrethana, kjo dukuri po merr përmasa shqetësuese në këto territore, veçanërisht duket sikur na ka gjetur të papërgatitur, sepse edhe vet struktura dhe veprimi i vetë familjes ndryshon ashtu që - nëse bëjmë një diferencë midis asaj se ku është numri më i madh i divorceve, normal që dinamika e jetës është më e madhe në qytete,

derisa në vendet rurale - ende si faktor ndikon ai tradicionalizmi dhe kjo dukuri më pak në numër shfaqet atje", sqaron Jakupi.

Edhe pse divorci ekziston që me paraqitjen e martesës në shoqërinë e parë sklavopronare, Jakupi vlerëson se kohën e fundit - gjatë zhvillimit të historisë, kanë ndryshuar kushtet dhe tani gjatë globalizmit - ndër shkaqet kryesore dhe moderne të kohës për ndarjet mes çifteve janë interneti dhe rrjetet sociale.

"Ndër shkaqet më të reja, të themi se edhe kjo ndodhë, por kjo është një pasojë e asaj se të rinjtë nuk e konsumojnë internetin dhe rrjetet sociale për atë çka janë të dobishme, por me siguri për kësaj ahengjesh dhe flirtesh të thosha unë në këtë aspekt dhe pohimi juaj mban, sepse një flirt është flirt i momentit, mirëpo pasojat janë shumë të mëdha dhe çdoherë parashtrahet pyetja se cilat janë ato pasoja, kush pëson edhe nga flirtet edhe nga divorci edhe nga keqkuptimet në familje? Kuptohet se viktima janë fëmijët. Në këndvështrimin tim, do të thosha se duhet një shkallë riedukuese para hyrjes një martesë për të kuptuar këtë proces si një proces mjaft të rëndësishëm e delikat dhe jo aq të lehtë, sepse përveç qëllimit primar të reproduksionit, ai ka edhe funksione tjera si hyrja në martesë! Dhe, nëse ti nuk je emocionalisht dhe ekonomikisht i gatshëm, atëherë është gjë normale që më shpejtë mund të vij deri tek divorci", thotë Jakupi.

Tetë vitet e fundit, respektivisht prej vitit 2009 deri në vitin 2016 - bazuar statistikën e ESHS-së, secilin vit kanë ndodhur prej mbi 1000 deri 2200 ndarje apo divorce. Sipas po këtyre të dhënave, numri i kurorëzimeve në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 është rritur për 1.6 për qind, dhe ka qenë 14.923. Në vitin 2009 ka pasur më shumë rritje të numrit të divorceve. Ky numër në 2009 ka shënuar rritje për 6.5% në krahasim me vitin 2008, dhe gjatë vitit 2009 janë divorcuar

1278 çifte. Numri i kurorëzimeve në vitin 2010, në krahasim me vitin 2009 është zvogëluar për 5.1 për qind, dhe ka qenë 14.155 çifte të kurorëzuara. Po këtë vit është rritur edhe numri i ndarjeve. Numri i divorceve në 2010 ka qenë 1720 çifte. Numri i kurorëzimeve në vitin 2011, në krahasim me vitin 2010 është rritur për 4.1 për qind, dhe ka qenë 14.736 çifte të kurorëzuara, ndërsa numri i divorceve ka shënuar rritje për 1.9 për qind në krahasim me vitin 2010, ose 1753 çifte të divorcuara. Në vitin 2012, në krahasim me vitin 2011, numri i kurorëzimeve është zvogëluar për 5.1 për qind, dhe ka qenë 13.991 çifte, derisa është rritur numri i ndarjeve - ose rritje për 9.9 për në krahasim me vitin 2011 (1926 çifte). Sipas të dhënave të Entit shtetëror për statistikë, numri i kurorëzimeve në 2013, në krahasim me vitin 2012 është zvogëluar për 0.1 për qind, dhe ka qenë 13.982 çifte të kurorëzuara, derisa numri i divorceve në 2013 ka shënuar rritje për 6.2 për qind në krahasim me vitin 2012 (2045 çifte). Numri i kurorëzimeve në vitin 2014, në krahasim me vitin 2013 është zvogëluar për 1.2 për qind, dhe ka qenë 13.813 çifte të kurorëzuara, ndërsa numri i divorceve ka shënuar rritje për 8.1 për qind në krahasim me vitin 2013 (2210 çifte). Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, numri i kurorëzimeve në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014 është rritur për 2.7 për qind, dhe ka qenë 14.186 çifte të kurorëzuara. Në këtë vit është ulur numri i ndarjeve. Numri i divorceve në 2015 ka shënuar rënie për 0.5 për qind në krahasim me vitin 2014 (2200 çifte të divorcuara). Numri i kurorëzimeve vitin e kaluar krahasuar me vitin 2015 është ulur për 7.0 për qind, dhe ka qenë 13.199 çifte të kurorëzuara. Vjet, numri i divorceve ka shënuar rënie për 9.8 për qind krahasuar me vitin 2015 (1985 çifte).

Taravari dhe Rama në Samitin e Brukselit



Shkup, 23 nëntor - Kryetari i Komunitetit të Gostivarit, Arben Taravari dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, do të marrin pjesë në Samitin vjetor evropian "Ballkani Perëndimor në udhëkryq-Sfidat e reja, ndryshimi i dinamikës", që do të mbahet më 5 dhjetor në Bruksel. Samiti, siç njoftojnë nga shërbimi për informim, organizohet në bashkëpunim me Konrad-Adenauer Stiftung, UNDP-në dhe United States European Comman (EUCOM) me mbështetje të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim (RCC), Komisioni Evropian dhe Rockefeller Brothers Fund. Samiti mbahet pak para miratimit të strategjisë së re të Komisionit Evropian për zgjerim në rajon, i paraparë të bëhet në fillim të vitit 2018. Në samit do të marrin pjesë edhe personalitete të tjera nga rajoni dhe nga Komisioni Evropian.

Nga e diela shi dhe dëborë

Shkup, 23 nëntor - Deri të shtunën do të mbajë mot i qëndrueshëm dhe i thatë, nëpër luginë me paraqitje të mjegullës veçanërisht në orët e pasdites, kumtoi Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike (DPHM). Të dielën pasdite fillimisht në pjesët perëndimore do të ketë të reshura të shiut, ndërsa në zonat malore dëborë. Gjatë natës ndaj të hënës të reshurat do të kalojnë në dëborë dhe në disa zona të larta. Të reshura të shiut dhe të dëborës do të ketë edhe të hënën paradite, ndërsa gjatë ditës do të fryjë erë e përfurcuar veriore që do të shkaktojë rënie të temperaturave.



Tetë vitet e fundit, respektivisht prej vitit 2009 deri në vitin 2016 - bazuar statistikën e ESHS-së, secilin vit kanë ndodhur prej mbi 1000 deri 2200 ndarje apo divorce

EKZISTON NË LETËR, PO NUK FUNKSIONON

TETOVA ENDE PA TRANSPORT TË ORGANIZUAR



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 nëntor - Në Tetovë ende nuk është vënë në funksion Ndërmarrja Publike për Transport Publik. E njëjta është themeluar para tre vitesh, por ekziston vetëm në letër. Komuna e Tetovës vite me radhë ka kërkuar nga Ministria e Transportit autobusë (tetë) t'i ndahen për të konkretizuar në vepër ndërmarrjen publike për transport.

Nga pushteti lokal në Tetovë thonë se vënia në funksion e transportit publik, do të ndikonte edhe në zvogëlimin e ndotjes si dhe përmirësimin e kaosit në komunikacionin e qytetit të Tetovës. "Në këtë drejtim, është mjaftë e arsyeshme që të kemi një shpërndarje proporcionale të mjeteve nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Sepse, me ndarjen e atyre autobusëve kontribuojmë edhe në kauzën tonë të përbashkët që kemi për ndotje sa më minimale të ajrit ambiental, por edhe të vihet në funksion transporti urban", theksuan nga Komu-

na e Tetovës.

Komuna e Tetovës tashmë shqyrton variantet për zgjidhjen e problemit të transportit urban, problem ky i vjetër. Pasi që komuna është duke pritur përgjigje nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve për furnizimin me autobusë, pritet që të gjejë mënyra të tjera për të vënë në praktikë funksionimin e Ndërmarrjes Publike Transportuese. Një variant për organizimin e transportit urban, është që të lidhet kontratë me kompani private që do të organizojë transportin publik në Tetovë. Kjo vlen për qytetin, ndërsa jashtë qytetit për në vendbanimet tjera e njëjta do të bëhet në koordinim me komunat rurale. Ditë më parë, kryetarija e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, tha se do të gjejnë mënyra për ta funksionalizuar këtë ndërmarrje.

"Qytetarët e Komunës së Tetovës kanë pasur mundësinë që të binden se ne, gjërat që i themi, edhe i bëjmë. Kjo dëshmon më së miri me ndërmarrjen e parkingjeve, e cila u themelua dhe për më-

Nga pushteti lokal në Tetovë thonë se vënia në funksion e transportit publik, do të ndikonte edhe në zvogëlimin e ndotjes si dhe përmirësimin e kaosit në komunikacionin e qytetit të Tetovës

pak se një vit, në fakt u bë funksionale. Do gjejmë mënyra, nuk dëshiroj të prejudioj se cilat do jenë mënyrat, por do të punojmë në drejtim të bërjes së këtij qyteti qytet", deklaroi Arifi.

Nga ana tjetër, përderisa Komuna e Tetovës të zgjidh mungesën e transportit publik, transporti i vetëm për qytetarët dhe studentët vazhdojnë të jenë furgonët, të cilët më së tepërmi pengojnë në komunikacion dhe krijojnë tollovi, duke mos pasur vendin e tyre adekuat për t'u

parkuar, se sa ndihmojnë qytetarët për transport. Përndryshe, gati se dhjetë vite qytetit të Tetovës i mungon transporti publik. Gjatë tërë kësaj kohe, pas falimentimit të ndërmarrjes auto-transportuese "Polet", transporti publik është i pa organizuar dhe i njëjti zhvillohet me furgonë dhe disa kompani të tjera private. Përndryshe, përderisa në të gjitha qytetet e Maqedonisë ka mini stacione të tilla, në Tetovë nuk ka asnjë. Udhëtarët, sidomos nxënësit e shkollave të mesme, nuk kanë një vend të caktuar ku do të presin autobusin dhe automjetet e transportit. Ata qëndrojnë në kushte të vështira klimatike jashtë, në shi, në borë, por edhe gjatë verës, duke pritur automjetin transportues. Vende të këtilla ku qëndrojnë ato janë në dalje të Tetovës për në Shkup, përballë monopolit, në hyrje të Tetovës, afër marketit Vero, në qendër afër Qendërs për Kulturë, te Gjykata e Tetovës, te Xhamia e larme dhe vende të tjera, por në asnjërin prej këtyre vendeve nuk ka mini stacion të mbulua.



Shkupi më i ndotur gjatë natës

Shkup, 23 nëntor - Në të gjitha komunat e Shkupit të mërkurën në mbrëmje ndotja e ajrit ishte në nivel shumë të lartë. Stacionet matëse tregojnë se koncentrimet e PM10 grimcave gjatë natës kanë tejkaluar 100 mikrogramë dhe kanë arritur deri në 400 mikrogramë në një metër kub. Në Karposh, Lisiçe dhe në Rektorat, koncentrimet e PM10 grimcave nga ora 8:00 deri në orën 14:00 kanë lëvizur rreth kufirit të lejuar maksimal prej 50 mikrogramë në një metër kub. Në Qendër, nga ora 20:00 deri në orën 05:00 të mëngjesit të ditës së enjte koncentrimet janë mbi 100 mikrogramë, me ç'rast ajri më i ndotur ka qenë në orën 20:00, 22:00 dhe në 05:00 të mëngjesit. Në Gazi Babë, koncentrimet të larta janë regjistruar nga ora 18:00 e deri në mëngjes në orën 08:00. Më i ndotur ka qenë ajri në orën 19:00 me 200 mikrogramë dhe 192 mikrogramë në orën 20:00. Në stacionin matës në Karposh, ajri më i ndotur ka qenë nga ora 18:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit të ditës së enjte, ku nga ora 20:00 deri në orën 22:00 janë vërejtur koncentrimet më të larta në këtë stacion matës, të cilat lëvizin mbi 200 mikrogramë. Ajri më i ndotur ka qenë në orën 20:00 dhe 21:00 me 235 mikrogramë, gjegjësisht 240 mikrogramë në një metër kub PM10 grimca.

Ajri më i ndotur të mërkurën në mbrëmje, ka qenë në Lisiçe. Janë regjistruar koncentrimet prej 405 mikrogramëve në një metër kub në orën 23:00. Ajri i ndotur në Lisiçe sipas matjeve në vazhdimësi, ishin prej mbrëmje nga ora 17:00 deri në orën 08:00 të mëngjesit të ditës së enjte. Nga ora 18:00 e deri në mëngjesin e së enjtes, ajri i ndotur është edhe në Rektorat. Koncentrimet kanë lëvizur prej 124 deri në 310 mikrogramë në metër kub. Në Shkup, prej të enjtes, si pjesë e masave për zvogëlimin e ndotjes së ajrit filloi aksioni për pastrimin e rrugëve, ndërsa nga fundjava do të ketë autobusë falas deri në Vodno të Mesme dhe ndalesë për automjete në Vodno. Ajri i ndotur ka qenë edhe në Manastir me koncentrimet më të larta të regjistruara prej 325 mikrogramë në metër kub, pastaj Tetovë me 375 mikrogramë, Kavadar me 416 mikrogramë dhe Kumanovë me 391 mikrogramë në metër kub.

"Esenca e ekzistencës" në Galerinë kombëtare të Kosovës

Shkup, 23 nëntor - Si rrjedhojë e nënshkrimit të memorandumit për bashkëpunim mes dy intitucioneve, Galerisë kombëtare të Maqedonisë dhe Galerisë kombëtare të Kosovës për materializimin e bashkëpunimit nëpërmjet lansimit e projektit të këtij viti, "Young Art Kosovo 2016", që u realizua në muajin prill, në Malla Stanica, ku kishin prezantimet e tyre Agron Blakçori, Bujar Sulejmani, Kolektivi HAVEIT, Jetulla Sulejmani dhe Luan Bajraktari, vjen projekti udhëtues nga Maqedonia "Esenca e ekzistencës" në Kosovë. "Esenca e ekzistencës" e kuratorëve nga Galeria kombëtare e Maqedonisë, Maja Çankulovska Mihajlovska, Goranço Gjorgjievski dhe Ana Frangovska, do të prezantohet edhe para publikut kosovar më 25 nëntor të vitit 2017 në Galerinë kombëtare të Kosovës, ku do të prezantohen njëzet artistë bashkëkohorë të Maqedonisë.

"Esenca e ekzistencës" është një koncept artistik i cili u drej-



tohet sferave të ndryshme të përditshmërisë, të jetës, ekzistencës, perceptimeve të cilat vijnë nga aspekte të ndryshme drejt esencës së qenies, të mbijetesës, të funksionimit. Këtu përfshihen gjenezat e dashurisë, shpirtërores, të ushqyerit... kurse nën këtë diskurs zbulohen edhe çështjet e dinjitetit, ideologjisë, politikës, jetës sociale. Zakonisht, kur bëhet fjalë për një tematikë që lidhet me ekzistencën, është e pashmangshme të përmendet Sartri dhe ekzistencialistët, të cilët flasin mbi absurditetin e fenomeneve socio shoqërore, që do të thotë për absurditetin e esencës në ekzistencë. Qëndrimet kritike mbi

ekzistencën e përditshme në vprat e ekspozitës "Esenca e ekzistencës" mund të kuptohen edhe në kontekst të reflektimit mbi "vështirësinë e papërballueshme të qenies", si parafrazë e titullit të romanit të mirënjohur të Milan Kunderës "Lehtësia e papërballueshme e qenies" dhe ofrojnë shembuj të ndryshëm të sistemeve represive shoqërore.

Ky koncept me një kuptim të përgjithshëm do t'i përfshijë aspektet e tridhjetë artistëve bashkëkohorë të Maqedonisë të cilët reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj parimeve ekzistencialiste, duke përdorur media të ndryshme të shprehje vizuale –

nga ato klasiket: piktura, grafika, skulptura, duke kaluar te instalimet, objektet, fotografitë, e deri te video projektimet, printimet digjitale, performansat, audioinstalimet. Artistët e përzgjedhur, Ismet Ramiçeviq, Metodi Angellov, Atanas Botev, Vana Urosheviq, Irena Paskali, Aleksandar Stankoski, Velimir Zhernovski, Gjorge Jovanoviq, Marija Sotirovska, Igor Sekovski, Osman Demiri, Sllavica Janeshlieva, OPA, Mihaela Jovanovska, Zero, Nehat Beqiri, Zeni Ballazhi, Zhaneta Vangeli, Dita Starova Qerimi, Igor Toshevski, Goce Nanevski, Dimçe Dimevski në fjalorin e tyre krijujes përdorin elemente të cilat i shkojnë për shtat diskursit kryesor të konceptit, ndërkohë që secili prej tyre i shqyrton gjërat esenciale të ekzistencës në mënyra të ndryshme dhe prej këndvështrimeve të ndryshme. Shprejshmë dhe besojmë se me këtë pamje tematike do të ofrojmë një mundësi këndvështrimi të artit bashkëkohor të Maqedonisë.

Kongresi i Manastirit

Nga

dr. Berton SULEJMANI



Ta kujtosh dhe ta nderosh me një aktivitet si ky i sotmi përvjetorin e Kongresit të Manastirit e në veçanti 109-vjetorin e tij, nuk është thjeshtë një nderim, por detyrë e obligim i brezit tonë për ata njerëz që s'kursyen asgjë, duke përballur ndjekjet, persekutimet dhe reprezaljet për të zgjidhur një nga çështjet më madhore të kulturës sonë, alfabetin e përbashkët të shqipes. Harrohej nga armiqtë tanë se vendi ynë u kishite dhënë popujve të tjerë njerëz të shquar: politikanë e diplomatë, dijetarë e studiues dhe vetë kishte pritur një kongres të abecesë që të vendosë grafinë e shkronjave shqipe, veçori kjo në fushën e kulturës sonë të vjetër e të re, një mbijetesë heroike e gjuhës amtare. Dhe rrallë mund të gesh edhe në gjuhët e popujve të tjerë shembuj të tillë, ku u pagua aq shtrenjtë e drejta për të pasur shkrimin e vet sa populli ynë. Vendosmëria e atdhetarëve shqiptarë për të gjetur një gjuhë të përbashkët për zgjidhjen e problemit të alfabetit, që po ushtronin qarqet e ndryshme atdhetare brenda dhe jashtë vendit, por në radhë të parë si fryt i bindjes së tyre të palëkundshme se zgjidhja e këtij problemi të rëndësishme nuk priste më. Përdorimi i disa alfabetëve të ndryshme për shkrimin e gjuhës shqipe po rrezikonte ta thellonte më tej përçarjen midis shqiptarëve në një kohë kur ata kishin nevojë më shumë se kurrë për bashkim në përpjekjet e tyre për t'i dhënë fund sundimit shumëshekullor osman. Mjafton të kujtojmë se në fillim të shekullit XX vetëm në Shkodër për shkrimin e gjuhës shqipe, krahas alfabetit tradicional të shkrimtarëve të vjetër të Veriut, përdorshin edhe alfabetet e shoqërive "Bashkimi" dhe "Agimi" e aty-këtu edhe alfabeti arab. Të kihet parasysh edhe përhapja e gjerë e alfabetit të shoqërisë së Stambollit të vitit 1879 si edhe përdorimi i disa alfabetëve të tjera, me bazë kryesisht latine, për botime shqipe në vende të ndryshme të botës.

Nga statistikë që ka nxjerrë prof. dr. Tomor Osmani, na del të kuptojmë se janë mbi 150 alfabetë, variante dhe nënvariate (ky numër mund të rritet në të ardhmen me zbulime veprash e dorëshkrimesh) të cilat janë hartuar për një periudhë 353-vjeçare që nga "Meshari" i Gjon Buzukut (1555) deri në Kongresin e Manastirit. Por shumë shpejt, shumica e tyre jo vetën nuk u përdorën,

por u harruan ashtu siç hynë, duke mbetur vetëm në arkivat e studiuesve tanë. Në vendin tonë alfabeti latin ishte më i përhapuri dhe kishte më shumë përkrahës, duke iu larguar në këtë mënyrë orientit dhe duke u drejtuar oksidentit të përparuar. Alfabeti grek dhe turko-arab, ndonëse patën një farë përhapjeje, nuk mund të pëlqeheshin nga shqiptarët si për shkaqe politike, shkencore e fetare. Klubi "Bashkimi" i Manastirit u bë nismëtar për thirrjen e një kongresi kombëtar që ka hyrë në histori si Kongresi i Manastirit. Në të morën pjesë 50 delegatë të shoqërive, klubeve dhe të organeve kombëtare të pjesës më të madhe të trevave shqiptare, si edhe të kolonive shqiptare në vende të ndryshme, shkrimtarë e gazetarë, lëvrues të gjuhës e të shqipes, veprimtarë të njohur të lëvizjes kulturore e politike kombëtare. Kongresi zgjodhi nga gjiri i tij një komision prej 11 anëtarësh, që përbëhej nga përfaqësues të tre alfabetëve kryesorë që ishin në përdorim. Në komision bënë pjesë Gjergj Fishta (kryetar), Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Mithat Frashëri, Shahin Kolonja, Dh. Buda, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriaz, B. Topulli, Nyzhet Vri-

ni, Grigor Cilka. Kongresi i zhvilloi punimet nga 14 e deri më 22 nëntor 1908, në hotelin "Liria" të Themistokli Gërmenjit, në Manastir. Pas mjaft diskutimesh, u krijua një alfabet i ri, i mbështetur i tëri në alfabetin latin.

Kongresi i Manastirit pati rëndësi të madhe jo vetëm për alfabetin dhe për gjuhën letrare kombëtare, për arsimin e për kulturën, por edhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në përgjithësi. Me të drejtë thuhet se pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ky është kuvendi që mbledhi shqiptarët nga të gjitha krahinat e vendit tonë, nga ngulmimet shqiptare e të tjerë, duke dhënë sinjalin e parë për pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar. Gjithashtu, ai për herë të parë në historinë tonë çeli rrugën e kongreseve për të diskutuar çështje madhore të kulturës sonë. Shkronjat e shqipes janë marrë nga alfabeti latin, por sistemi i shkrimit dhe sistemi grafik i shqipes ka disa veçori, që i japin një karakter deri diku sui generis. E para ndër këto veçori është përcaktimi se alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 shkronja, ndërsa alfabeti latin, po të përfshijmë në të edhe w (v-në dyfishe), ka 26 shkronja. Siç dihet, kur paraqitet alfabeti i gjuhëve të til-


Nga statistikë që ka nxjerrë prof. dr. Tomor Osmani, na del të kuptojmë se janë mbi 150 alfabetë, variante dhe nënvariate, të cilat janë hartuar për një periudhë 353-vjeçare që nga "Meshari" i Gjon Buzukut (1555) deri në Kongresin e Manastirit



la si anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja, renditen 26 shkronjat e alfabetit latin. Kombinimet e tyre për të shënuar fonema të veçanta nuk numërohen si shkronja më vete. Pse në gjuhën shqipe zbatohet një praktikë tjetër dhe njohim si shkronja të veçanta gj e nj, dhe th, ll e rr, sh xh e zh? Arsyeja kryesore për këtë mendohet se mund të përmblidhet në pohimin se alfabeti ynë i sotshëm përfaqëson një tejkrim (transkriptim) tërësisht me shkronja latine të alfabetit të Shoqërisë së Stambollit (1879) prej 36 shenjash të njëvlershme. Pra, Kongresi i Manastirit latinizoi ato shkronja jolatine të alfabetit të Stambollit, duke ruajtur po atë renditje të tyre. Vendimi i Kongresit, siç dihet, linte në fuqi alfabetin e Stambollit dhe alfabetin e ri. Nga vetë mënyra e paraqitjes në vendim shihet se alfabeti i ri është simetrik nga ana sasiore dhe e vlerave të grafemave me alfabetin e Stambollit, çdo shkronjë e këtij të fundit ka shkronjën përgjegjëse me alfabetin e ri. Një simetri e tillë e plotë nuk vërehet në alfabetet e mëparshme.

Arsyeja e dytë pse në alfabetin tonë numërohen 36 shkronja ka të

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 23 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

bëjë me sistemin grafik të shqipes d.m.th. me mënyrën se si i plotësuan kongresistët e Manastirit mungesat e alfabetit latin për të shënuar 36 fonemat e shqipes. Çdo dyshkronjësh në gjuhën shqipe shënon vetëm një fonemë dhe secila prej këtyre fonemave shënohet vetëm nga dyshkronjëshi përkatës. Një krahasim me gjuhë të tjera e nxjerr në pah këtë veçori të sistemit tonë grafik: në gjermanishte, në italishte, në anglishte fonema /sh/ mund të shënohet me disa shkronja e bashkime shkronjash, kurse në gjuhën shqipe kjo fonemë shënohet kurdoherë me bashkimin s+h dhe ky bashkim shënon kurdoherë fonemën /sh/. Kështu edhe për të gjitha dyshkronjëshat e tjerë e po ashtu për shkronjat me shenja diakritike (ç, ë). Kjo rrethanë, që çdo fonemë është e lidhur me një grafemë të caktuar dhe çdo grafemë shënon, si rregull, një fonemë të vetme, është një tipar dallues i sistemit grafik të shqipes me krahasim me një varg gjuhësh të tjera që përdorin gjithashtu alfabetin latin. Për të gjitha këto që në abetare mësojmë se alfabeti ynë ka 36 shkronja dhe prandaj në fjalorët e gjuhës shqipe fjalët që nisnin me gj, dh, ll, rr, sh, th, xh, zh nuk renditen te shkronja e parë e këtyre dyshkronjëshave, por në një shkronjë më vete.

Me të vërtetë historia e alfabetit të gjuhës shqipe qe një rrugë e gjatë, e mundimshme dhe e dhimbshme, por atdhetarët shqiptarë arritën ta zgjidhin atë. Gjithnjë trajektorja ka lëvizur në të mirë të alfabetit latin për shqipen, si më i përshtatshëm, më i gjetur dhe më funksional. Kështu kultura shqiptare me këtë zgjidhje që bëri, miratoi përfundimisht emancipimin drejt Evropës së qytetëruar, duke u bërë faktor i rëndësishëm i individualitetit kulturor të popullit tonë. Për në fund, me të drejtë I. Kadare, shkrimtari ynë i madh, në promovimin e dy veprave "E bija e Agamemnonit" dhe "Pasardhësit", 14 vjet më parë (2003), me rastin e festimeve të 95-vjetorit të Kongresit të Manastirit në Shkup, tha: "Alfabeti ynë i sotëm është i mrekullueshëm, i përshtatur shumë mirë gjuhës shqipe. Ai i qëndroi kohës, alfabet i përkryer, i unifikuar, i bashkuar. Alfabeti i sotëm i mbështetur në atë latin ishte rrjedhojë e kulturës latine". E paçim për jetë e mot abecenë tonë!

(Autori është shefi
Programit Studimor të
Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në
Universitetin e Tetovës)

Problemet e muzikës shqiptare sot?



Nga
Aleksandër LALO

Problemi i parë i muzikës shqiptare është se mungon kritika muzikore. Jo vetëm kritika muzikore, por edhe kritika letrare. Kjo ndodh për shumë arsye... U ndërruan sistemet dhe u ngatërrua fjala diktaturë, censurë me fjalën liri pa fund. Por ne harruam se muzika e kultivuar u ndërta pas çlirimit, muzika e kultivuar e mirëfilltë. U krijuan orkestrat simfonike, u krijuan operat, baletet dhe shumë institucione arti. Ishte e detyrueshme në atë kohë, që arti të stimulohej, ashtu si edhe kinematografia. U vunë piketat urdhëruese. Ne kompozitorëve na thuhej që të kompozonim duke u mbështetur në folklorin tonë, në frymën e këngëve tona. Këto në fakt nuk i konceptonte gjithkush, pasi dikush i ka marrë dhe si urdhëresa, por në fakt, mua për shembull më ka bërë mirë shkuarja në Kukës. Pra, largimi nga Tirana më bëri që të njihem shumë mirë me folklorin e atij vendi, asaj zone. Pra nuk më bëri keq. Por si çdo sistem, ka pasur

anët negative, por nuk ka pasur të bëjë me censurën, kishte të bënte me njëfarë orientimi, ndaj dhe u krijuan operat, u krijuan baletet, u krijuan dhe shumë institucione të tjera të artit. Në njëfarë kohe u hoqën veprat klasike botërore që të viheshin në skenë veprat tona, të autorëve tanë. Sot nuk ke një balet të ri tëndin, nuk ke një operë të re edhe pse ke kompozitor të shkëlqyer, edhe pse ke muzikant shumë të talentuar, edhe pse ke koreograf shumë të talentuar apo dhe libretist për teatër shumë të talentuar. Sot nuk ka askund vepra shqiptare. Pse? Sepse nuk u jepet prioritet. Globalizmi kuptohet keq, se sot mund të prodhosh gjithçka pa hapësirë. Por jo çdo gjë që shtypet në piano, duhet të dalë në skenë. Brezi që kaloi dhe pedagogët e mi kishin një autocensurë. Nuk them se në këtë hapje të madhe të Shqipërisë nuk ka dhe gjëra të sakta. Ka! Por, për këto gjëra të sakta duhet të jetë një kritikë muzikore, e cila duhet t'i evidentojë, që brezi i ri tani, t'i ketë si

pika referimi se nga duhet të drejtohet, pasi janë shumë gjëra në skenë. Për të shkuar në një qytet janë shumë rrugë dhe ne duhet t'i orientojmë këta muzikantë të rinj se nga cila rrugë duhet të shkojë te ky qytet. Ka një lloj çorientimi, që po humbasin vlerat. Ne kemi hyrë në një sistem që njeriu mund të bëjë gjithçka, por jo gjithçka duhet të dalë në treg. Duhet ato filtrat, ajo censura artistike që gjërat që nuk kanë vlerë të mos i jepen publike. Ato janë si ato ushqimet e skaduara që i heqin nga qarkullimi, nga mësohesh me gjëra të skaduara, nëse mësohesh me gjëra që nuk duhet të jenë në treg, atëherë kur të vjen një mall i mirë, me vlerë, na duket se ai është i skaduar. Pra, mungon kritika e mirëfilltë muzikore, profesionale, e shëndoshë, korrekte. Kur del në një skenë, në një festival, në një institucion shtetëror me një krijim jo profesional, atëherë unë nuk vë në faj autorin, por edhe median. Në këtë rast janë

bashkëfajtorë, autori dhe media. Ka dhe një diçka tjetër, në Shqipëri ka një amalgamë midis profesionistëve dhe diletantëve. Kjo sepse vjen një diletant, jo amator, që ka një aftësi për të bërë muzikë dhe lidhet me një studio muzikore, me emër, profesioniste dhe diletanti paguan për të bërë një këngë. Kështu, lidhet një krushqi midis një diletanti dhe një profesionisti. Bëhet një kompromis jo i saktë, ku kompromisi është paraja. Dikush justifikohet që me këtë unë jetoj. Këtu faji është i shpërndarë, nuk është vetëm i atij që aq di, por më shumë është i pjesës tjetër, që bëhet pjesë e këtij fenomeni. Ky faj bëhet më i madh se shkohet në një media, bëhet dhe një reklamë, paguhet dhe një lek më shumë dhe faji shpërndahet në disa drejtime. Nuk ke ku e zë këtë faj. Është njësoj sikur të përziësh miellin e grurit me të misrit e të thekrës dhe pastaj ta ndash. Nuk ka sitë në botë të ndajë këtë përzierje kaq të ngatërruar...

(shekulli)

Gazetari shqiptar

NË SHIRITIN E KOHËS



Mihal GRAMENO

Zotoja ishte djalë i ri, i mësuar në dituri në Evropë dhe si mbaroi mësimet e larta u hodh në luftë kombëtare duke botuar një gazetë shqip për të mbrojtur të drejtat e mëmëdheut për të cilin i qante zemra natë e ditë



Ja dhe dy net mbetni, tha Zotoja, që na ndajnë nga moti i ri, kur kthehej në dhomë të tij, edhe buzët i nënqeshën në këtë mejtim. Kishte arsye ta priste me kaq gas meqenëqë gjithë bota: të pasur, të vobektë, të mëdhenj, të vegjël e gjithë fatzinjtë e presin me gojë hapët këtë ditë të shënuar, me shpresë të bukur të një kanisku, një darove, një lodre, ose një ndryshimi të rrojtjes, kështu pra, Zotoja tonë shpresonte nga moti i ri ndonjë ndryshim. Si hyri brenda ndezi kandilen, nxori nga xhepet një paketë të vogël mbështjellë me një gazetë dhe e vuri mbi tryezë, pastaj ndenji afër mbi fron edhe ai vetë. Në pakte nuk kishte gjësendi tjetër përveç pesë para bukë edhe pesë para ullinj. Kjo ishte gjithë darka e Zotos! Ishte i stërvitur në këtë rrojtje, andaj pa psherëtim, si hëngri bukën, shojtji kandilen edhe ra të flerë që të ngrohej në shtrat meqenëse soba ishte më e ftohtë nga akulli. Sa për mobiljet e dhomës ishte lehtë për të vrejtur: Një shtrat me një jorgan të vjetër, një tryezë, një fron, një kandile, një qelqe me ujë, në fund të dhomës ishte përdhe një tok me gazeta. Kjo ishte gjendja e Zotos, të shkëlqyerit gazetar shqiptar!...

Me gjithë këto asnjë dëshpërim nuk rrëfente fytyrë e tij, po i kënaqur e me durim të patundur, shpresonte të mbushte qëllimin e shenjtëruar, duke mbrojtur të drejtat e kombit të tij përpara botës së qytetëruar. Zotoja ishte djalë i ri, i mësuar në dituri në Evropë dhe si


mbaroi mësimet e larta u hodh në luftë kombëtare duke botuar një gazetë shqip për të mbrojtur të drejtat e mëmëdheut për të cilin i qante zemra natë e ditë. Pas një moti plot therori trupore e materiale, xhepet i zbrazi prej kohe e tani priste motin e ri duke shpresuar në mëmëdhetarët që do të kujtoheshin dhe do të mbushnin detyrën e tyre duke dërguar të paktën, në mos ndonjë ndihmë, pajtimin e gazetës.

Nga ky shkak ishte më i çelur këtë natë Zotoja ynë në kujtim të motit të ri. Ra të flerë po gjumi nuk i afrohej, gjithë natën u dërmua në shtrat duke shkruar ndër mend një mijë ëndërra fluturake e një qind hesape. Nga 500 pajtimtarë, thoshte, do të vinë të paktën 2000 franga. Kështu pra, do të paguaj gjithë detyrimet: Në shtypshkronjë do të paguaj për gjashtë muaj të shtypurit e gazetës se nuk duan të ma shtypin më, qiranë e dhomës e të shpëtojnë nga gojë e zonjës që më tremb me të përzënë, restorantet që më kanë tharë prej kohësh gushmaqne, dhe në kafenet që s'ma varin fare kapistallë, pastaj do të blej dru për zjarr, një pal rroba e një pallto për të ndërruar pardesynë verake me një okë lyrë mbi të, këpucë, këmishë, pastaj të rroj edhe unë si njeri duke lagur lugën me ndonjë gjellë e të vete në kafenet e mëdha si gazetar i një kombi edhe pastaj... pastaj... këtu qëndroi nga hesapet dhe, duke përdredhur mustaqet, buzët i nënqeshën. Deh! Ishte njeri, edhe i ri, andaj dhe Zotos i fluturoi

mendja te syzeza Rozinë! Do ta bind, tha, me një palë vëthë të artë dhe do të më përgjigjet në dashuri. Këto mendonte gazetari ynë, e mundet të mos mbaronte nga këto mendime po të mos hapëj dita e të zbriste poshtë për të marrë letërshtëmbimët që solli postieri. Midis shumë letrave i jep dhe një të madhe të papaguar, duke i thënë: një frang është taksa e kësaj letre. Fort mirë, thotë Zotoja, duke u kuqur, por s'kam të prishura, t'i jap nesër. Çka të bëjë, përgjigjet postieri, i cili shpresonte të nesërmen ndonjë darovë të motit të ri. Si hyri brenda, ndezi një cigare dhe zuri të hapte letrat në të cilat kishte varur gjithë shpresat. Ç'pandehni se gjeti brenda? Dorëshkrime më mërira të veçantë, vjersha dashurie edhe urime për motin e ri duke e ngritur Zoton gjer në majë të lumturisë! Po ca nga këto ishin edhe më të çuditshme. Njeri shkruante që të madhonte formën e gazetës edhe ta botojë më dendur, një tjetër e qortonte për programin, një tjetër për shkronjat, kurse një tjetër i shkruante: je një tradhëtor i shitur te të huajt duke marrë nga një-mijë franga në muaj. Vetëm njëri i dërgonte tri franga të pajtimt duke dhënë shpresë se kusurin do t'ia jepte motin tjetër. Ha! Ha! la dha të qeshurit Zotoja dhe si ndezi një cigare doli në qytet. I pari kujdes ishte të blente me të tria frangat një jakë e një kravatë, një çapare për kapellën, një bukë e një kokë lakre arme për të ftohur stomakun...

(Botuar më 1909)

GIOVANNI FALCONE



Falcone kishte një dozë të fortë fatalizmi të tërin sicilian. Një ditë, ai do të thoshte: "Kultura e vdekjes... E gjithë Siçilia është e mbarsur me të. Tek ne, dita e të vdekurve është festë e madhe: ofrojmë ëmbëlsira që quhen koka e të vdekurit, të bëra me sheqer të ngurtë si guri. Vetmia, pesimizmi, vdekja janë temat e letërsisë sonë... Sikur të jemi një popull që ka jetuar shumë dhe si pasojë ndihet i lodhur, i boshatisur, si Don Fabrizio di Tomasi i Lampeduzës". E dinte që mafia do ta vriste, shkruan një gazetar britanik që e intervistoi në vitin 1991

MAGJISTRATI QË "DUHEJ TË VDISTE"

Nga John FOLLAIN

Giovanni Falcone i njihte mirë rreziqet që i kanoseshin. "Llogaria që ke hapur me Cosa Nostran nuk do të mbyllet", e kishte paralajmëruar i superpenduari Tommaco Buscetta. I vetëdijshëm për ato fjalë, Falcone do të shkruante në kujtimet e tij: "Është e vërtetë, ende nuk më kanë hequr qafe. Por llogaria ime me Cosa Nostran mbetet e hapur. Do ta shlyej me vdekjen time, natyrore apo jo". Gazetarëve që e pyesnin se si e përballonte frikën, magistrati palermitan i përgjigjej me sinqeritet: "Mendimi për vdekjen më shoqëron kudo. Por, siç thotë Montaigne, shndërrohet shumë shpejt në një natyrë të dytë. Sigurisht, është mbi ata që jetojnë, bëhen llogari, vëzhgime, duhet të organizohesh, shmangen zakonet e përsëritur, qëndrohet larg nga situatat që mund të mos mbahen nën kontroll. Por fitohet edhe një dozë e mirë fatalizmi. Në fund të fundit mund të vdesësh për arsye të ndryshme, një aksident rrugor, një avion që shpërthen në ajër, një mbidozë, kanceri, apo edhe për asnjë arsye të veçantë".

"DO TË VDES NGA DORA E MAFIAS"

Megjithatë, në biseda private, Falcone kishte shumë pak dyshime mbi mënyrën se si do të përfundonte jeta e tij dhe i kish rrëfyer një kolegu në gjykatën e Palermos: "Do të vdes nga dora e mafias. Mafia do të më vrasë". Dhe magistrati Francesco Lo Voi i thoshte: "Dëgjo, vendimi tashmë është marrë, kanë bërë gati kontratën për të më vrarë".

Sipas bashkëbiseduesit të tij, Falcone nuk e dinte se kur apo si do ta vrisnin, por ishte i vetëdijshëm që, duke u pozicionuar kaq hapur kundër mafias, do të ishte i pashmangshëm shënjestrimi i tij. Falcone kishte një dozë të fortë fatalizmi të tërin sicilian. Një ditë, ai do të thoshte: "Kultura e vdekjes... E gjithë Siçilia është e mbarsur me të. Tek ne, dita e të vdekurve është festë e madhe: ofrojmë ëmbëlsira që quhen koka e të vdekurit, të bëra me sheqer të ngurtë si guri. Vetmia, pesimizmi, vdekja janë temat e letërsisë sonë... Sikur të jemi një popull që ka jetuar shumë dhe si pasojë ndihet i lodhur, i boshatisur, si Don Fabrizio di Tomasi i Lampeduzës".

Por ai nuk kishte aspak ndërmend që t'ua lehtësonte detyrën armiqve të tij. Për të, siguria personale ishte detyrimi numër një i aty-

re që pozicionoheshin kundër Cosa Nostras: ishte një çështje profesionalizmi, ashtu si edhe fakti i njohjes së ligjit. "Unë i njoh rreziqet që ndërmarr kur bëj këtë profesion që bëj, dhe nuk besoj se duhet t'i bëj një dhuratë mafias duke iu ofruar asaj si një shënjestër e lehtë", shpjegonte ai. "Kush përfaqëson autoritetin e shtetit në territor armik ka detyrën që të mos ketë asnjë dobësi. Të paktën në limitet e parashikueshmërisë".

QYTETARË TË NDRERSHËM

Falcone merrej në mënyrë skrupuloze me sigurinë e tij. Pak përpara vrasjes së shefit të tij, këshilltarit Rocco Chinnici, ministria e drejtësisë i kishte dërguar nga Roma një jelek antiplumb. Falcone ishte skeptik. Një të diel pasdite i nxori njerëzit e eskortës së tij në një fshat jashtë Palermos dhe u

Falcone merrej në mënyrë skrupuloze me sigurinë e tij. Pak përpara vrasjes së shefit të tij, këshilltarit Rocco Chinnici, ministria e Drejtësisë i kishte dërguar nga Roma një jelek antiplumb. Falcone ishte skeptik. Një të diel pasdite i nxori njerëzit e eskortës së tij në një fshat jashtë Palermos dhe u kërkoi që të kolaudonin jelekun antiplumb: e goditën disa herë pa asnjë problem



kërkoi që të kolaudonin jelekun antiplumb: e goditën disa herë pa asnjë problem.

Dy truprojat e para iu caktuan në verën e vitit 1980, një ditë pasi vrasës me motoçikleta kishin ekzekutuar me pistoletë Gaetano Costan, atëherë kryeprokurore i Palermos. Brenda disa viteve grupi i shoqërimit i Falcones u rrit në 36 vetë, të cilët aliternoheshin mes tyre, secili me jelek antiplumb dhe me automatikë. Kishin katër automjete shoqërimi, që transportonin magistratin duke ecur me bllokazh nëpër peizazhin sicilian me sirena të pandalshme dhe me ngjyrë blu. Vargu i makinave shoqërohej nga një helikopter i policisë mes shtëpisë së magistratit dhe aeroportit. Kur mbërrinin tek pallati i Falcones, ku një polic i armatosur, në rojë 24 orë në 24 kontrolonte hyrjen, tre vetë hipnin bashkë me të në ashensor deri në katin e katërt, ndërkohë që dy të tjerë u paraprinin duke hipur nga shkallët. Një truprojë e kalonte natën në katin ku ndodhej apartamenti i tij. Zhurma dhe prania e grupeve të shoqërimit të Falcones shkaktonin shqetësim për fqinjësinë e tij. Një grua i dërgoi një gazete vendëse një letër proteste. E quante veten një "qytetare të ndershme që paguan taksat" dhe sugjeronte që Falcone dhe kolegët e tij të antimafias të strehoheshin në vila të ndërtuara posaçërisht në periferi të Palermos, për të garantuar paqen dhe qetësinë e "qytetarëve që punojnë" dhe, mbi të gjitha, për të bërë që të ndalen plagosjet dhe vrasjet e vazhdueshme "pa motiv" të palermitanëve, gjatë atentateve kundër prokurorëve dhe magistratëve. Këto shfryrje më në fund e futën në siklet Falconen, i cili ndiente një dashuri të pamatë për qytetin e tij. I krahasonte trishtueshëm palermitanët me spektatorët e një ndeshjeje me dema, për paafësinë e tyre për t'iu kundërvënë mafias. Zbulimet e të super penduarit Buscetta dhe dënimet e maksi procesit nuk e kishin prekur aspak konsensusin popullor që gëzonte Cosa Nostra. Pikërisht ashtu si gjenerali Dalla Chiesa, Falcone ishte, për shumëkënd, vetëm një njeri që hapte telashe, një kërcënim për shoqërinë. (Sette)

"ZONJA E HEKURT"

NJË SFIDË PËR

REGJIMIN E ERDOGANIT



Një parti e re e udhëhequr nga Meral Akşener, një grua e vendosur me prejardhje nga Ballkani, premton të trondisë politikën e Turqisë dhe t'i hapë punë presidentit Erdogan

Kundërshtarë të presidentit turk Recep Tayyip Erdogan kanë shpresa se vendi një ditë do të kthehet në formën parlamentare të demokracisë, e cila është hequr pas ndryshimeve të diskutueshme në kushtetutë. Disa sondazhe, të bëra publike gjatë ditëve të fundit, tregojnë se se Partia e sapokrijuar Iyi (E mirë) ka fituar mjaft mbështetje publike për të sfiduar establishmentin politik aktual. Partia filloi zyrtarisht vetëm në fund të muajit të kaluar, me sloganin "Turqia do të jetë e mirë" dhe një diell të ndritshëm si logon e saj. Pluralizmi politik, sundimi i ligjit, liria e shprehjes dhe vlerat patriotike janë parimet bazë të saj. Liderja e saj 61-vjeçar Meral Akşener, një politikanë e shquar e krahut të djathtë dhe ish-ministre e brendshme, shihet si një kundërshtar serioze ndaj Erdoganit përpara zgjedhjeve të ardhshme presidenciale në vitin 2019.

Një sondazh i publikuar më 6 nëntor nga SONAR sugjeroi se Partia Iyi të fitonte të paktën 16 për qind të votave në rast zgjedhesh të menjëhershme. Ditë më parë, kompania kërkimore "Gezici" vlerësoi gjithashtu se partia mund të fitonte pothuajse 20 për qind të votave, në një kohë kur partitë e tjera kryesore tregojnë rënie të konsiderueshme në renditjet e tyre. Analistët thonë se partia i bën thirrje njerëzve sepse ajo ofron alternativën e vetme reale për partitë që janë tani në pushtet. "Partia qeverisëse Drejtësi dhe Zhvillim, AKP, është kampionja e dekadës së fundit në Turqi. Një nga arsytet më të rëndësishme për këtë situatë është se asnjë parti tjetër s'mund të konkurrojë kundër AKP-së. Ka pasur mungesë opozite serioze, kështu që elektorati nuk pati zgjedhje tjetër", tha për BIRN Gozde Kilic-Yasin, një analiste politike nga Anka-

raja. Anketimet e fundit e tregojnë vetë Aksenerin në vend të dytë pas Erdoganit në zgjedhjet e ardhshme presidenciale që priten të mbahen në vitin 2019. Kompania "Gezici" sugjeron se në rast zgjedhesh presidenciale, 38 për qind e votuesve do të votonin për të, vetëm 10 për qind pas 48 për qindëshit që dëshiron të mbështesë Erdoganin. Pronari i "Gezici", Murat Gezici, tha për shërbimin turk Sputnik më 1 nëntor se Aksener do të kishte gjasa të rriste sasinë e votave të marra me afrimin e zgjedhjeve sepse ajo kishite marrë një qëndrim shumë të ashpër kundër partisë në pushtet dhe publiku ndjente simpati për të si një grua të ashpër.

"Hulumtimi ynë tregon se gjysma e elektoratit ka pak simpati për Partinë e Mirë, ndërsa Aksener mund të jetë një rivale e madhe kundër j Erdoganit në garën presidenciale. Hulumtimet tregojnë potencial të vërtetë për partinë e re dhe drejtuesen e saj", tha Gezici. Disa analistë të tjerë thonë gjithashtu se programi i saj mund t'i bëjë thirrje një numri të madh votuesish. "Aksener mund të jetë rivalja e vetme e Erdoganit dhe Partia e Mirë po mirëpritet nga një numër i madh njerëzish", tha për BIRN Kursat Guc, një ekspert i politikës turke nga Universiteti i Ankarasë.

NJË "ZONJË E HEKURT" MENJË PREJARDHJE NGA BALLKANI

Aksener lindi në vitin 1956 në qytetin industrial të Kocaelit, nga një familje boshnjako-turke që emigroi fillimisht nga ajo që tani është Maqedonia. Rajoni i saj i lindjes është shtëpi e shumë njerëzve që u larguan nga Ballkani për në Turqi, me rënien e Perandorisë Osmane-boshnjakë, shqiptarë dhe turq etnik në veçanti. Ajo filloi të punonte në shërbimin publik, njësoj si shumë femijë të tjerë emigrantësh nga Ballkani, dhe u bë mësuese dhe më vonë profesoreshë në universitet. Në vitin 1994, ajo kandidoi për kryetare në komunën e Kocaelit, por humbi. Disa vjet

më vonë, ajo u zgjodh si deputete nga Partia Rrugë e Drejtë, DYP, dhe u bë ministre e brendshme e Turqisë gjatë një periudhe turbulencash politike, nga nëntori 1996 deri në korrik 1997.

Pavarësisht kërcënimeve me vdekje për të dhe familjen e saj, ajo qëndroi e fortë kundër ushtrisë, që prej kohësh donte të dominonte politikën turke dhe shkarkoi shumë oficerë të lartë policie dhe guvernatorë, të cilët kishin punuar me regjimin ushtarak gjatë "Memorandumit Ushtarak Turk 1997". Aksener fitoi shpejt pseudonimin "Zonja e Hekurt". "Ajo u pa si një alternativë në politikën e Turqisë, ku rivalitetet janë mizore dhe ka shumë pak vend për gratë", theksoi Kursat Guc. Si anëtare e Partisë së Lëvizjes Nacionaliste të ekstremit të djathtë, MHP, ajo u rizgjodh si deputete në vitin 2007 dhe u bë gruaja e dytë në historinë turke që shërbeu zi v/kryetare e parlamentit.

Gjatë kohës që ajo kaloi në këtë post, ajo meritoi sërish pseudonimin e saj "Zonja e Hekurt" me deklaratat e saj të ashpra publike dhe menaxhimin e seancave parlamentare vërtet me një grusht të hekurt. Megjithatë, vitin e kaluar, Aksener u përjashtua nga MHP, bashkë me disa anëtarë të tjerë të lartë, pas smarrësive që patën me drejtuesin e partisë, Devlet Bahçeli. Muaj më vonë, mbështetja e Bahçelit për Erdoganin e ndihmoi atë të fitonte referendumin e diskutueshëm dhe ndarës me anë të të cilit Turqia kaloi nga një sistem parlamentar në një sistem presidencial ekzekutiv.

SHËRIMI I NJË SHOQËRIE TË POLARIZUAR

Partia u themelua më 25 tetor me një premtim për të shkundur mirë politikën e Turqisë. Pesë anëtarë të parlamentit turk të përbërë nga 550 vende e kanë mbështetur që në fillim partinë, ndërsa shumë figura të tjera të njohura publike kanë treguar mbështetjen e tyre për platformën e saj të qendrës së djathtë. Analistët thonë se një nga asetet kryesore të partisë është gatishmëria e saj për të trajtuar të gjitha këndvështrimet e ndryshme politike të vendit. "Partia e Mirë synon t'i japë fund polarizimit të shoqërisë, e cila e ka prekur atë për shumë vite. Deri më tani, partia në pushtet e ka ndarë atë në aspektin e grupeve të ndryshme fetare, ideologjisë politike, prejardhjeve etnike madje edhe gjinore, për të konsoliduar bllokun e saj të votimit", tha Kursat Guc. Në shfaqjet e saj të para publike si drejtuese e partisë së re, Akşener ka thënë se ajo dëshiron të mbledhë bashkë të gjithë këta njerëz të ndryshëm, të qendrës së djathtë, nacionalistë apo votues demokratikë. "Ne do t'i japim fund të gjitha ndarjeve në shoqëri, në mënyrë që populli turk të mund të takohet rreth tryezës së Bajramit. Të gjithë do të jemi të mirë dhe të barabartë rreth tryezës", tha Akşener në vizitën e saj të fundit më 28 tetor. Fakti që një numër i madh njerëzish të mirëbesuar janë të përfshirë në parti shihet gjithashtu si relevante.

"Shumica e themeluesve të partisë janë luftëtarë të njohur kundër korrupsionit dhe ryshfetit, ose janë fytyra të reja, kështu që niveli i vëmendjes së publikut tek partia e re dhe drejtuesja e saj është i lartë. Megjithatë, ne do të presim zhvillime të ardhshme dhe do të shohim si dalin kandidatët e partisë në zgjedhjet e ardhshme. Shumë gjëra ndryshojnë lehtë në politikën turke", tha Gozde Kilic-Yasin.

DHËNIE FUND TË PRIRJES DREJT LINDJES SË MESME NË POLITIKËN E JASHTME

Sipas programit të partisë, partia synon të shërojë marrëdhëniet e dobëta të Turqisë me BE-në dhe NATO-n dhe t'i japë fund asaj që e quan "orientim drejt Lindjes së Mesme" të politikës së jashtme, duke iu referuar largimit të Turqisë nga Perëndimi dhe afrimit drejt botës myslimane arabe nën drejtimin e Erdoganit. "Partia jonë do të ndjekë një politikë të jashtme kombëtare në lidhje me të drejtën ndërkombëtare - të balancuar, të besuar, të qëndrueshme, të orientuar drejt zgjidhjes dhe të shumëfishtë. Vendi ynë do të jetë përsëri në nivelin e qytetërimit bashkëkohor dhe do të shpëtojë nga ky orientim drejt Lindjes së Mesme", thuhet në program. Kilic-Yasin beson se nëse Partia e Mirë fiton pushtetin, ajo do të përpiqet patjetër të shërojë marrëdhëniet me Perëndimin, pasi këto marrëdhënie konsiderohen si vendimtare për paqen dhe stabilitetin e të gjithë rajonit. "Me shumë gjasa, Partia e Mirë do të përpiqet të shmangë manovrat dhe temat e rrezikshme të politikës së jashtme", tha ajo. Theksi do të vihet në "axhendën e anëtarësimit në BE dhe rëndësinë e anëtarësimit në NATO. Ballkani, Azia Qendrore dhe Kaukazi do të jenë përsëri në krye të listës së prioritetëve", shtoi ajo. Partia e Mirë ka thënë se synon të përqendrohet më shumë te Ballkani, pasi atje "mendjet dhe zemrat e miliona njerëzve janë me Turqinë". "Ne s'duhet të harrojmë se Akşener është bija e një familje emigrante nga Ballkani dhe në parti ka shumë anëtarë të tjerë nga diaspora. Këto janë arsye personale për të pritur një politikë aktive ballkanase nga Partia e Mirë", tha Kursat Guc. "Aksener beson se marrëdhëniet më të mira me qeveritë rajonale, duke shmangur çdo konflikt dhe lëvizje të rrezikshme, janë në favor të turqve dhe shoqërive të tyre të afërme (siç janë boshnjakët dhe të tjerët) në rajon", shtoi Guc. "Ne mund të jemi të sigurt se anëtarët e diasporës ballkanike do të marrin pozicione të larta në parti, kështu që përparësia e çështjeve të Ballkanit do të çonte në një qeveri të mundshme të Partisë së Mirë".

(BIRN)



Deri më tani Prishtina dhe Beogradi kanë arritur një varg marrëveshjesh në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, përfshirë edhe Marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve në prill të vitit 2013, e cila parasheh formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe



PA AMERIKËN, S'KA MARRËVESHJE ME SERBINË

Përfshirja e drejtpërdrejtë e Shteteve të Bashkuar të Amerikës, krahas Bashkimit Evropian në fazën përfundimtare të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë është e domosdoshme, në mënyrë që të sigurohet një marrëveshje përfundimtare, e pranueshme dhe e zbatueshme për të dy palët, thonë deputetë dhe njohës të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ata thonë se pa përfshirjen e SHBA-së në këtë proces, është e vështirë të ketë një marrëveshje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë. Deputetja Time Kadrijaj (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) nga Komisioni për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës, thotë se me prezencën e një përfaqësuesi amerikan në dialogun Kosovë-Serbi, mund të ketë më shumë mundësi për një marrëveshje finale dhe garanci për zbatimin e marrëveshjeve të arritura. "Dikur dialogu duhet të përfundojë dhe prezencën e një përfaqësuesi amerikan në dialog është një garanci se të gjitha marrëveshjet do të zbatohen dhe në fund të arrihet një rezultat. Krejt kjo duhet të përfundojë me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve", tha Kadrijaj, raporton REL. Ishte presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili gjatë vizitës së tij të fundit në Nju Jork, ka kërkuar përfshirjen e SHBA-së në procesin e dialogut Prishtinë-Beograd. Thaçi në takim me zëvendës-presidentin amerikan, Mike Pence pati thënë se "përfshirja direkte e SHBA-së në fazën përfundimtare, është përcaktuese për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare, të zbatueshme për të dy palët". Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka thënë se në takim me përfaqësuesen e lartë të BE-së, Federica Mogherini, ka ngritur çështjen e dialogut, me kërkesën që tash e tutje të jetë edhe një përfaqësues nga Shtetet e Bashkuar të Ame-

rikës në tavolinën e bisedimeve. Profesori i të Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Afrim Hoti, thotë se prezencën e një përfaqësuesi amerikan në dialogun politik Kosovë-Serbi është e domosdoshme, pasi që sipas tij, Shtetet e Bashkuar të Amerikës kanë qenë garantuese të shumë marrëveshjeve për Kosovën. "E para lidhet me aspektin historik, tash më e dëshmuar që sa herë që SHBA-të kanë qenë në tryezë për Kosovën, në mënyrë të natyrshme kemi pas edhe suksesin e negociatave, për të cilën gjë kosovarët janë ndjerë të garantuar me vet prezencën amerikane. Argumenti i dytë lidhet me pozicionin jo shumë të favorshme dhe jo shumë homogjen të BE-së, aq më tepër kur kihet parasysh fakti se një numër i këtyre shteteve jo që nuk e njohin Kosovën, por kanë filluar të kenë edhe rol destruktiv kundrejt zhvillimeve në Kosovë. Kjo nga pala kosovare shihet si proces që në vete bartë rreziqe", tha Hoti. Analisti politik Ilir Ibrahim thotë se përfshirja e drejtpërdrejtë e Shteteve të Bashkuar të Amerikës, në dialogun politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në fazën e fundit të dialogut do të luan një rol të rëndësishëm në arritjen e një marrëveshjeje. Por, sipas tij duhet shikuar a ka vullnet nga SHBA-ja që të jetë në tryezën e bisedimeve apo jo.

"Nuk e shoh si diçka të dëmshme, një prani më të madhe të SHBA-ve në këtë dialog, andaj edhe duhet të gjendet mundësia që të përfshihet në këtë dialog. Mirëpo, edhe ne duhet ta luajmë rolin tonë në këtë rast sepse ne nuk jemi duke dërguar mesazhe pozitive ndaj SHBA-ve, sidomos për çështjen e Demarkacionit, ku kemi një lloj mospërfillje nga Qeveria e Kosovës ndaj deklaratave të Shteteve të Bashkuara", tha Ibrahim. SHBA ka qenë pjesë e dialogut teknik në vitin 2011-2012 pasi ka dërguar përfaqësuesit e saj gjatë bisedimeve në Bruksel. Përfaqësues të organizatave jo-qeveritare në Kosovë kanë thënë se pas gjashtë vjetësh, që nga fillimi i dialogut në Bruksel, përveç ngecjes në planin e zbatimit të marrëveshjeve, raportet në mes Kosovës dhe Serbisë janë tensionuar. Deri më tani Prishtina dhe Beogradi kanë arritur një varg marrëveshjesh në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, përfshirë edhe Marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve në prill të vitit 2013, e cila parasheh formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Qëllimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sipas Bashkimit Evropian, është relaksimi i raporteve ndërmjet dy vendeve në mënyrë që Kosova dhe Serbia të vazhdojnë tutje me procesin e integritimit evropian.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka thënë se në takim me përfaqësuesen e lartë të BE-së, Federica Mogherini, ka ngritur çështjen e dialogut, me kërkesën që tash e tutje të jetë edhe një përfaqësues nga Shtetet e Bashkuar të Amerikës në tavolinën e bisedimeve.

Nuk do të ishte mirë që Kosova të shkojë në zgjedhje



Pas zgjedhjeve të fundit, Peterle theksoi se ka ardhur koha për veprim. Ai theksoi se nuk do të ishte mirë që Kosova të shkojë në zgjedhje të reja, pasi që tha se ka dëgjuar se Kosova mund të shkojë sërish në zgjedhje. "Disa nga problemet janë disa dobësi që janë vërejtur edhe në zgjedhjet e kaluara. Duhet të theksojmë qartazi, që vlerësimet tona do të kenë kuptim vetëm nëse rekomandimet tona merren parasysh dhe implementohen. Shpresoj që së shpejti nuk do të ftohem të vëzhgojmë zgjedhjet në Kosovë. Mendoj se pas këtyre zgjedhjeve ka ardhur koha për veprim", tha Peterle. Peterle bëri të ditur edhe që misioni që ai udhëheq do të qëndroj në Kosovë deri më 7 dhjetor të këtij viti, pra deri sa të shpallen rezultatet përfundimtare.

Refuzojnë të punojnë, në grevë 140 të burgosur në Dubravë

Disa të burgosur në burgun e Dubravës kanë hyrë në grevë për shkak se nuk janë të kënaqur me ligjin e ri i cili ua zvogëlon atyre pushimet vjetore. Greva e 140 të burgosurve të pavionit 6 ka filluar që nga e hëna. Këtë e ka konfirmuar edhe ushtruesi i detyrës së Shërbimit Korrektues të Kosovës Sokol Zogaj. Ai tha se ata janë të qetë dhe të disiplinuar ndërsa forma e grevës së tyre është refuzimi për të punuar, transmeton Kosovapress. "Po janë në protestë rreth 140 të burgosur të pavionit 6 në Burgun e Dubravës, ata po refuzojnë punën për shkak se nuk janë të kënaqur me ligjin e ri, ne jemi duke biseduar edhe me ministrin e Drejtësisë për të bërë gjithçka në mënyrë që ato nene për të cilat të burgosurit nuk janë të kënaqur të ndryshohen. E po ashtu kemi mbështetje edhe nga Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës dhe Avokatit të Popullit", tha Zogaj. Me ligjin e ri të burgosurit kanë më pak pushim vjetor sesa më herët.

Prishtina dhe Prizreni në rinumërim

Valdete Daka në mbledhjen e KQZ-së mori vendim që të vazhdohet me numërimin e votave me kusht në komuna ku nuk ka mundësi ndërrimi të rezultatit, si dhe sipas saj propozimi nga PZAP që të fillon rinumërimi për Komunën e Prizrenit në të gjithë vendvotimet, si dhe 35 vendvotime në Dragash, rinumërimi i 3 vendvotimeve në Rahovec dhe rinumërimi i tërësishëm i votave në Prishtinë të ndodh pas numërimit të këtyre votave me kusht. Ishte Adnan Rustemi ai që e

kundërshtoi përsëri një gjë të tillë sepse tha se as nuk është vendim i drejtë sepse ende nuk janë numëruar votat me kusht dhe me post. "Nuk ka pasur asnjë ankesë për ecurinë e procesit të votimit në Prishtinë, dhe asnjë raportim në dhomën operative të KQZ-së, ka pas ankesa për disa vendvotime dhe e kem vendimin për rinumërim të plotë", tha Rustemi. Ai tha se është kundër dhe KQZ me një vendim të sotëm po hyn edhe në një vendim jo ligjor, sepse po bënë veprim para Gjykatës

Supreme. Daka tha se nuk e ka marrë ajo këtë vendim dhe ka ardhur njësoj sikur ai në mbledhje. "Nuk mundem unë ta detyroj askënd, gjithkush e bartë përgjegjësin ligjore dhe morale për veprimet e veta", tha Daka. Daka pavarësisht replikave që pati në mbledhje, mori vendim që të vazhdohet me numërimin e votave me kusht për këto komuna, që nuk kanë probleme dhe parregullsi dhe pastaj të vazhdojë rinumërimi i komunës së Prizrenit dhe Prishtinës.



TË JESH "AGJENT I HUAJ" NË SHBA DHE NË RUSI!



Si përgjigje ndaj masave të SHBA kundër transmetuesve rusë, Kremli do të regjistrojë tani edhe mediet si "agjentë të huaj". Po çfarë kuptojnë me këtë koncept në SHBA dhe në Rusi?

"Jemi të detyruar që të reagojmë ndaj përndjekjes së stacionit televiziv Russia Today (RT) në SHBA", deklaruan deputetë të Dumës shtetërore në mes të nëntorit 2017. Ata patën miratuar ndryshime ligjore, në bazë të të cilave mediat e huaja mund të kategorizohen si "agjentë të huaj" në Rusi. Edhe në SHBA ka një ligj për agjentët e huaj - Foreign Agents Registration Act (FARA). Autoritetet amerikane futën para pak kohësh në këtë listë RT dhe radiostacionin rus Sputnik. Koncepti "agjent i huaj" ka në rrisht një kuptim negativ dhe barazohet me fjalën "spion". "Edhe një anglishtfolës me anglishten gjuhë amtare do të mendonte se bëhet fjalë për spiunazh", i thotë DW Eliot Borenstein, profesor i gjuhëve sllave në New York University. Por dallimi është se në Rusi me këtë ligj duan të stigmatizojnë të gjithë shoqërinë civile, kurse regjistrimi në FARA i RT në SHBA ndjek një "synim më të ngushtë". Sipas Borensteinit, me të synohet të shenjohen radiostacione ruse, që e minojnë sistemin politik amerikan. Në zhargonin politik një "agjent i huaj" megjithatë nuk është spiun, por një lobiist, puna e të cilit financohet nga një shtet tjetër. Ligji FARA i SHBA u miratua në vitin 1938, për të vepruar kundër propagandi-

stëve të Gjermanisë naziste. Ndryshimet e bëra në vitin 1966 synonin në radhë të parë të preknin lobiistët politikë, të cilët vepronin me porosi të shteteve të huaja. Këta mund të jenë si persona juridikë, ashtu edhe persona fizikë. Ligji rus për agjentët e huaj është i vitit 2012. Dihet që ai është një reagim i udhëheqjes ruse për protestat masive në dimër 2011 dhe pranverë 2012. Në formën e tij të mëparshme, ai prekte vetëm organizatat jofitimprurëse. Por pesë vjet më vonë ai u zgjerua edhe tek mediet. Në vështrim të parë, ligji rus dhe ai amerikan për agjentët e huaj kanë shumë ngjashmëri, për shembull në regjistrimin në ministrinë e Drejtësisë dhe në nevojën për të paraqitur raporte llogaridhënieje. Por në Rusi, agjentët e huaj duhet t'i nënshtrohen një verifikimi vjetor

dhe të paraqesin çdo gjashtë muaj një raport për veprimtarinë e tyre. Disa përcaktime janë më të ashpra në ligjin amerikan. Për shembull kopje të materialeve informative duhet të paraqiten te autoritetet më e vona 48 orë pas publikimit të tyre. Ligji i FARA-s kërkon që materialet propagandistike të shënjojnë si të tilla. Por në praktikë këto rregulla nuk zbatohen siç del nga një raport i inspektorit të ministrisë së Drejtësisë të vitit 2016. Kur një person ose një organizatë drejtohet ose kontrollohet direkt nga një qeveri ose organizatë e huaj, atëherë ajo mund të deklarohet agjente e huaj në SHBA. Kurse në Rusi mjafton që të marrësh para nga jashtë, për t'u kategorizuar i tillë. Kjo vlen edhe për mediat. Potencialisht, çdo medie mund të deklarohet agjent i huaj në Rusi.

ZBATIM I NDRYSHËM

Por dallimi kryesor konsiston në faktin se regjistrimi si "agjent i huaj" në bazë të legjislacionit amerikan nuk sjell me vete kufizimin e aktivitetit. Ministria ruse e Drejtësisë nga ana tjetër i paralajmëroi një sërë mediesh amerikane për "kufizimin e mundshëm të veprimtarisë së tyre në Rusi". Shkelja e dispozitave të sjell në SHBA në teori pesë vjet burg ose deri në 10.000 dollarë. Por që prej vitit 1966 në gjyq kanë shkuar vetëm shtatë raste, dhe vetëm në një rast u mor vendimi për shkelje të ligjit. Në Rusi, ligji për agjentët e huaj ka çuar në mbylljen e një sërë organizatash jofitimprurëse. Dhe OJF që janë në listën e "agjentëve të huaj", përjetojnë diskriminim.

Pas 65 vitesh, një president i Turqisë viziton Greqinë



Zëvendëskryeministri i Turqisë, Hakan Çavushoglu tha se presidenti i këtij vendi Recep Tayyip Erdoğan do të jetë presidenti i parë turk i cili do të vizitojë Greqinë pas 65 vitesh. Duke folur për vizitën e cila do të realizohet gjatë ditëve në vijim, Çavushoglu tha se "Kemi tre projekte konkrete. Njëri prej tyre është ekspedita e trageteve për transportin e njerëzve dhe mallrave nga Izmiri në Selanik. Projekti i dytë ndërtime i linjës së trenit të shpejtë nga Stambolli për në Selanik dhe i treti ndërtime i urës në portat doganore Kipi dhe Ipsala". Çavushoglu tha se vizita e presidentit Erdoğan në Greqi do të ngritë marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy vendeve në një nivel më të mirë. Ai bëri të ditur se në fillim të këtij muaji edhe ai vetë ka vizituar Komotinin, që është vendlindja e tij. Çavushoglu tha se në kuadër të vizitës së tij ka zhvilluar kontakte në Athinë dhe në Thrakinë Perëndimore. Lidhur me vizitën të cilën presidenti Erdoğan do të realizojë në Greqi, Çavushoglu tha se presidenti Erdoğan do ta vizitojë Greqinë si një president i Republikës së Turqisë për herë të parë pas 65 vitesh. "Mendoj se kjo vizitë do të ketë rezultate shumë të rëndësishme. Gjatë vizitës sime në rajonin e Thrakisë Perëndimore, ne u pritëm me një dashamirësi të madhe nga bashkatdhetarët tanë në Komotini dhe Ksanthi. Kjo është sigurisht një emocion që buron nga prania e presidentit tonë, i cili gjithmonë mendon për ata dhe zemra e të cilit rrah për ta. Ky është një emocion i cili buron nga ajo që shohin se një Turqi 80 milionëshe është pranë tyre".

Ministri i Jashtëm i Bangladeshit ka njoftuar se me ministrin për Zyrën e Këshilltarit Shtetëror të Myanmarit, Kyaw Tint Swe, kanë nënshkruar "marrëveshjen për rikthimin e personave të zhvendosur nga rajoni i Arakanit"



Marrëveshje për rikthimin e muslimanëve të Arakanit

Bangladeshi dhe Mianmari janë dakorduar që të rikthehen në territoret e tyre muslimanët e Arakanit që janë strehuar në Bangladesh pas largimit nga mizoritë me të cilat u përballën. Sipas mediave të Bangladeshit, mësohet se ministrja e Punëve të Jashtme dhe përgjegjëse e çështjeve të Presidencës së Myanmarit, Aung San Suu Kyi, këtë mëngjes ka kryer një takim për 45 minuta me ministrin e Jashtëm të Bangladeshit, Mahmud Ali. Ministri i Jashtëm i Banglade-

shit, pas takimit ka njoftuar se me ministrin për Zyrën e Këshilltarit Shtetëror të Myanmarit, Kyaw Tint Swe, kanë nënshkruar "Marrëveshjen për rikthimin e personave të zhvendosur nga rajoni i Arakanit". Ndërkohë bëhet e ditur se nuk është publikuar ndonjë detaj në lidhje me marrëveshjen dhe nuk është specifikuar data në të cilën muslimanët e Arakanit do të kthehen. Mijëra muslimanë të Arakanit kanë humbur jetën që nga 25 gushti e deri më tani si rezultat i sulmeve të ushtrisë së Myanmarit, e cila pretendon se është duke luftuar me militantë të armatosur. Numri i saktë i viktime-

ve ende nuk mund të verifikohet, për arsye se qeveria e Myanmarit nuk lejon hyrjet dhe daljet në rajon. Gjatë sulmeve të cilat janë shndërruar në një spastrim etnik janë djegur ose shkatërruar rreth 300 fshatra nga ushtria dhe budistët radikalë, si dhe mbi 600 mijë muslimanë të Arakanit janë larguar në Bangladesh nëpërmjet rrugëve malore, detare apo të lummenjve. Muslimanët e Arakanit që kanë arritur të kalojnë në Bangladesh, ballafaqohen me shumë probleme për mundësitë e pamjaftueshme në kampe, veçanërisht me shëndetin dhe strehimin.

EKSKLUZIVE: DOKUMENTE QË SHOHIN DRITË PËR HERË TË PARË

Një nga kërkesat e banorëve të Negotinës së Gostivarit, ishte që RTV—Shkupi një program të tij ta ketë në gjuhën shqipe, të zgjeruar e të begatuar, objektiv e i hapur. Në të kundërtën, kishin potencuar në kërkesën e tyre, nuk do ta kryejmë obligimin e parapagesës

Nga Qerim LITA

Gazeta shqiptare KOHA – Shkup, javëve në vazhdim do të shpalojë disa dokumente arkivore (letra, kërkesa, parashtrës, reagime të qytetarëve dhe shoqërive civile shqiptare si dhe platformat politike të PPD-së e të PDP-së etj.), drejtuar Kuvendit Republikan, kryetarit të Republikës, Qeverisë së RSM-së si dhe institucioneve tjera republikane, federative e ndërkombëtare gjatë vitit 1991, përmes të cilave shprehet pakënaqësia dhe revolta e mbarë popullit shqiptar në RSM-ë, kundër politikës diskriminuese e antishqiptare, që asaj kohe zbatohet nga ana e organeve legjislativë e ekzekutive të kësaj republike. Publikimin e këtyre dokumenteve e fillojmë me botimin e letrës, përkatësisht kërkesës së banorëve të fshatit Negotinë të Gostivarit, hartuar në tubimin e mbajtur më 29 mars të vitit 1991, e cila u drejtohet organeve më të larta federative e republikane. Dokumenti prej dy faqesh gjendet në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë, fondi 159, të cilin në vazhdim po e shpalojmë në tërësi:

“Të brengosur thellë nga miratimi i disa ligjeve në mbledhjet e fundit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, nga rezultatet e disa mbledhjeve tjera, ne mbi 3.000 banorë të fshatit Negotinë, nga tubimi i mbajtur më datë 29. 03. 1991, kërkojmë me sa më poshtë vijon:


1. Kryetari i RSM-së—zotëri Kiro Gligorov të mos i nënshkruaj dy ligjet e miratuara (me mbivotim e majorizim) në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Maqedonisë, veçmas Ligjin për arsimin parashkollor, fillor e të mesëm.

ÇKA KËRKUAN BANORËT E NEGOTINËS NGA ORGANET FEDERATIVE E REPUBLIKANE



Negotina sot

Administrata—evidenca pedagogjike në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën amtare shqipe, detyrimisht duhet të udhëhiqet në gjuhën shqipe, kurse në të kundërtën nuk do të pajtohemi këtë evidencë ta mbajmë vetëm në gjuhën maqedonase.



kompetente të komunës e Republikës u mbyllën vetëm për shkakun se ky territor është i banuar me shqiptarë. Në fshatin tonë shkollimin fillor e mbarojnë 60 nxënës në vit, të cilët për arsye të largësisë së shkolles dhe për arsye të gjuhës jo-amtare, nuk kanë mundësi e kushte të përfshihen në mënyrë të barabartë në shkollat e mesme me moshatarët e nacionalitetit maqedonas.

3. Shqiptarët nuk janë pakicë apo minoritet (siç pretendohet në çdo mbledhje të Kuvendit Republikan e në disa tubime të ndryshme), por janë komb sovran që jetojnë në vatrat e tyre etnike dhe se në RSM-ë realisht marrin pjesë për mbi një të tretën nga numri i përgjithshëm i banorëve,

përkundër asaj se në Parlamentin Republikan marrin pjesë vetëm me 19% të deputetëve të deleguar.

4. Administrata — evidenca pedagogjike në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën amtare shqipe, detyrimisht duhet të udhëhiqet në gjuhën shqipe, kurse në të kundërtën nuk do të pajtohemi këtë evidencë ta mbajmë vetëm në gjuhën maqedonase.

5. Është përt'u habitur se si RSM ka mundësi të mbajë dy universitete, ndërsa në asnjërin prej tyre nuk ka ndonjë shkollë të lartë ose fakultet, ku mësimi do të zhvillohej edhe në gjuhën shqipe, prandaj kërkojmë të formohen disa fakultete, ku mësimi do të zhvillohet në gjuhën shqipe për arsye se i plotësojmë të gjitha kushtet.

6. Në Kuvendin Republikan, për çështjet themelore, siç janë të drejtat kombëtare, arsimit, kultura, simbolet, gjuha, toponimet e tjerë, të vendoset me konsensus, në të kundërtën asnjë vendim nuk do ta pranojmë i cili do të miratohet me mbivotim apo me majorizim.

7. Në të gjitha komisionet për regjistrimin e popullsisë (republikane, komunale, lokale), i cili do të mbahet nga data 1—15 prill të këtij viti, të përfshihen në mënyrë përkatëse edhe shqiptarët, për arsye se me të drejtë do të dyshohet në rezultatet e regjistrimit, si jo reale, prandaj do të jemi të detyruar regjistrimin ta bojkotojmë.

8. Kërkojmë që RTV—Shkupi një program të tij ta ketë në gjuhën shqipe, i cili do të zgjerohet e begatohet, të jetë objektiv e i hapur, sepse në të kundërtën nuk do ta kryejmë obligimin e parapagesës.

9. Kërkojmë që në komunat ku jetojnë shqiptarët — gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare e barabartë me gjuhën maqedonase, konkretisht

në mënyrë të barabartë të përdoret dygjuhësia pa prioritetin e asnjërës gjuhë.

10. Kërkojmë të ndërpriten urgjentisht akuzat e shpifjet e pabaza, të cilat bëhen nga ana e Lidhjes së Luftëtarëve nga Komuna e Gostivarit dhe nga organizatat tjera të ngjashme ndaj shqiptarëve, të cilat nuk përbëjnë asgjë tjetër, përveç se janë disa mbeturina të Jugosllavisë së vjetër.

11. Të ndërpriten masat represive, të cilat në kohë të fundit janë përforcuar kundër kombit shqiptar, siç janë: mbyllja e dyqaneve, lokaleve, dënime pa bazë e shkas në komunikacion, marrja dhe mosdhënia e dokumentit të udhëtimit etj.

12. Të lirohen sa më parë të gjithë të burgosurit politik, të cilët janë dënuar në RS të Maqedonisë.

13. Kërkojmë të miratohet Ligji i ri zgjedhor e të shpallen zgjedhje të reja e të parakohshme.

14. Kërkojmë që RS e Maqedonisë të jetë shtet sovran edhe i kombit shqiptar.

15. Nëse nuk shqyrtohen e plotësohen kërkesat tona, atëherë nuk na ngelet gjë tjetër, përveç se për këto çështje të shqiptarëve në Gostivar e Maqedoni, t'u drejtohem organizatave të ndryshme ndërkombëtare, prandaj nuk bartin as çfarë përgjegjësie për pasojat e metutjeshme, si dhe të kërkojmë që menjëherë të tërhiqen 23 deputetët shqiptarë nga Parlamenti republikan”.

Pasojnë nënshkrimet e banorëve të fshatit Negotinë



Të rihapen sa më parë shkollat e mesme në gjuhën amtare për vitin shkollor 1991/92 në Komunën e Gostivarit e në komunat tjera, të cilat u mbyllën para disa viteve nga burokratët dhe dogmatikët e sistemit komunist, të cilët edhe sot e kësaj dite janë në

pushtet. Në fshatin tonë ekzistonin paralele të gjimnazit, të cilat me nismën e organeve kompetente të komunës e Republikës u mbyllën vetëm për shkakun se ky territor është i banuar me shqiptarë. Në fshatin tonë shkollimin fillor e mbarojnë 60 nxënës në vit, të cilët për arsye të largësisë së shkolles dhe për arsye të gjuhës jo-amtare, nuk kanë mundësi e kushte të përfshihen në mënyrë të barabartë në shkollat e mesme me moshatarët e nacionalitetit maqedonas.

Fatiç largohet nga FC Shkupi

Shkup, 23 nëntor – Ivan Fatiç nuk është më futbollist i FC Shkupi. Futbollisti malazez ka mbyllur aventurën e qëndrimit në Çair, duke kërkuar largimin nga klubi. Largimi i 29-vjeçarit ka ardhur me kërkesë të futbollistit, i cili për shkaqe familjare nuk ka mundur të qëndrojë më gjatë në Shkup.

Ndryshe, malazezi për FC Shkupi kishte vetëm dy paraqitje, fillimisht i duhej kohë për të rikthyer formën, pasi më parë kishte gjashtë muaj pa luajtur dhe stërvitur. Kryesia e FC Shkupit, i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Fatiçit dhe njëherit i dëshuroi sukses në karrierë. Kujtojmë, Fatiç te FC Shkupi arriti marrëveshje në orët e fundit të afatit kalimtar të verës dhe ishte një nga përforcimet më të bujshme, duke marrë parasysh se

karriera e tij ishte e lidhur me ekipe të mëdha të Serisë A italiane, si Interi, Kievo e shumë skuadra tjera me famë.

Futbollistët e Pelisterit pa rroga plot 5 muaj

Shkup, 23 nëntor - Skuadra e Pelisterit përpos krizës së rezultateve, tani përballë edhe me krizë financiare. Në fakt Futbollistët e kësaj skuadre plot 5 muaj nuk kanë marrë të ardhurat mujore dhe një klimë të keqe do të zhvillojnë sfidat me FC Shkupin të dielën dhe Pobodën në kuadër të Kupës së Maqedonisë. Ndryshe, spekulimet dita ditës shkojnë në drejtim të reformimit të klubit dhe ndryshimit të aksionarëve të klubit nga Ma-

nastiri, ndërsa futbollistët mezi presin një zgjidhje afatgjate dhe natyrisht edhe shlyerje të borxhit.

Xhemali kërkon rikthimin te Bolonja

Parashikohet një rikthim në Itali për Blerim Xhemalin, futbollistin shqiptar, i cili aktualisht luan në "Major League Soccer" me skuadrën kanadeze të Montreal Impakt. Për të qenë në formën maksimale në Botërorin, Rusi 2018 me përfaqësuesen zvicerane, futbollisti nga Bogovina e Tetovës, dëshiron me çdo kusht të rikthehet te Bolonja dhe të luajë me skuadrën kuqeblu nga janari deri në mars, periudhë në të cilën kampionati amerikan është pushim.

ALIJIN DO E THËRRAS EDHE PA SKUADËR



Seleksionuesi i Kombëtares së Shqipërisë Kristian Panuçi, në konferencën e djeshme për shtyp foli edhe për mundësinë e grumbullimit të Naser Alijit edhe pse pa ekip.

"Me të gjithë menaxherët e futbollit që janë në botë, më duket e çuditshme që Aliji s'ka ekip. Duke qenë se besoj te ai, e mora në Turqi, por nëse s'ka skuadër as në mars, do vijë edhe në mars. Doja t'i jepja një mundësi dhe t'i tregoja disa gjëra se si punohej", u shpreh Panuçi. Kujtojmë, futbollisti nga Nikushtaku i Kumanovës është pa skuadër, pasi prishi para kohe kontratën me Kaizerslauternin, e cila luan në Bundesligën 2 gjermane. Kësaj skuadre Aliji iu bashkëngjiti në vitin 2016 nga Bazeli, por ende nuk ka mundur të gjejë skuadër. Pavarësisht kësaj, parashikohet se lojtarët të cilët kanë mbetur pa ekip, mund të regjistrohen me një skuadër pavarësisht mbylljes së

Duke qenë se besoj te ai, e mora në Turqi, por nëse s'ka skuadër as në mars, do vijë edhe në mars. Doja t'i jepja një mundësi dhe t'i tregoja disa gjëra se si punohej", pohon Panuçi

afatit të transferimeve. Ndërkohë, Panuçi foli edhe njëherë për fitoren e arritur në miqësore ndaj Turqisë. "Mendoj se në pjesën e parë ndaj Turqisë pamë punën që kemi bërë në Antalia. Luajtëm një futboll të shkëlqyer. Në fakt, u bënë dy ndeshje, në pjesën e parë kishim shumë kualitet, ndërsa në pjesën e dytë kur, mbetëm me 10 loj-

tarë, luajtëm me karakter. U demonstrua ai karakter që unë dëshiroj, duke mos toleruar asgjë. Futbollistët kanë qenë të jashtëzakonshëm gjatë qëndrimit në Antalia, rezultati është produkt i këtij qëndrimi profesionist", tha Panuçi. Do të kemi një grumbullim në mars, ku do të shohim 2-3 futbollistë. Duhet të kemi një bazë të rëndësishme, për të krijuar grupin që do të jetë në eliminatorët e Evropianit. Janë 5-6 lojtarë të cilët i kam parë në video, por duhet t'i shoh edhe nga afër. E sigurt që do të ketë prurje të reja në mars", përfundoi seleksionuesi i kuqezinjve.



Kristian Panuçi

Si italian më vjen shumë keq që përfaqësuesja e vendit tim ka mbetur jashtë Botërorit, por faji është i të gjithë sistemit, asgjë nuk është e rastësishme. Do të jetë shumë e vështirë për Italinë që të kthehet në nivelet më të larta. Italia nuk dëshiron t'i gjejë elementët për të ndërtuar një kombëtare të fortë, por ky nuk është problem im.

RENDITJA E FIFA PËR MUAJIN NËNTOR

Përparojnë Maqedonia, Shqipëria e Kosova

Shkup, 23 nëntor - Federata Ndërkombëtare e Futbollit e ka publikuar dje renditjen më të re të kombëtareve të futbollit, për muajin nëntor sipas së cilës, Maqedonia, Shqipëria e Kosova kanë shënuar një ecje para për 9 vende. Fitorja në miqësoren ndaj Norvegjisë ka kontribuar që Maqedonia, tani të mbajë pozitën e 76-të, në renditje dhe në kohë të njëjtë për 9 muaj të shënojë një ecje fantastike për plotë 90 pozita. Ndryshe kjo është renditja më e mirë e Maqedonisë, në tre vitet e fundit, ashtu që një renditje të tillë kishte në gushtin e 2014-tës. Ndryshe, fitorja 3-2 e mi-

qësore ndaj Turqisë, e luajtur në Antalia, e ka ngjitur në "ashensor" kombëtares kuqezi. Shqipëria tani e sheh veten 9 vende më lart se muaji i kaluar. Nëse në tetor 2017, kuqezinjtë pozicionoheshin në vendin e 71-të, me 551 pikë, duke humbur 5 vende krahasuar me muajin pararendës, për nëntorin e këtij viti ata e shohin veten në vendin e 62-të, me 498 pikë. Ndërkohë, përfaqësuesja e Kosovës që ishte në vendin e 183 ajo tani e sheh veten nëntë pozita më lart, në vendin 174. Nuk ka ndryshime në mesin e pesë kombëtareve më të mira në këtë renditje të FIFA.



19 MLN EURO NË SEZON PËR TË KALUAR TE BARÇA!

Mesfushori i Arsenalit, që është në skadencë kontrate me skuadrën e Wenger, kërkon plot 370 mijë euro në javë, një shumë ekuivalente me 19 milionë euro në vit. Një shpenzim të tillë Barcelona mund t'ia lejojë vetes vetëm nëse në janar largon Arda Turan, paga e të cilit rëndon jo pak arkate "blaugranave"

Mesut Ozil ia ka bërë të qarta kërkesat e tij ekonomike presidentit të Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, nëse ky i fundit dëshiron shërbimet e tij. Mesfushori i Arsenalit, që është në skadencë kontrate me skuadrën e Wenger, kërkon plot 370 mijë euro në javë, një shumë ekuivalente me 19 milionë euro në vit. Një shpenzim të tillë Barcelona mund t'ia lejojë vetes vetëm nëse në janar largon Arda Turan, paga e të cilit rëndon jo pak arkate "blaugranave". Përveç pagës "faraonike", Ozil kërkon edhe bonuse të tjera. Wenger, që tashmë e ka të qartë se nuk do ta ketë lojtarin në shërbim të tij sezonin e ardhshëm, është i predispozuar që ai të arrijë marrë-


veshjen me Barçën, vetëm që të mos i bashkohet Hoze Murinjos te Mançester Junajtedi. Madje ekzistojnë të gjithë mundësitë që kalimi në "Camp Nou" të ndodhë që në janar, me lojtarin që do të federohet menjëherë në Çampions, pasi Arsenali këtë sezon merr pjesë në "Europa League". "Topçinjtë" janë të fokusuar për t'i rrëmbyer Shalkes 23-vjeçarin Goretzka, i cili do të ishte në qendër të projektit të drejtuesve të Arsenalit. Të njëjtin lojtar e kërkon edhe Barça, që mund t'i hapë rrugë skuadrës së Wenger nëse siguron kartonin e Ozil.



Përveç pagës "faraonike", Ozil kërkon edhe bonuse të tjera. Wenger, që tashmë e ka të qartë se nuk do ta ketë lojtarin në shërbim të tij sezonin e ardhshëm, është i predispozuar që ai të arrijë marrëveshjen me Barçën, vetëm që të mos i bashkohet Hoze Murinjos te Mançester Junajtedi

Jam i lumtur te Çellsit

Eden Hazard, këmbëngul se është i lumtur te skuadra e Çellsit, por përsëri pranoi se e admiron Real Madridin. 26-vjeçari, shpesh është lidhur me një largim nga "Stamford Bridge", ku ka ardhur nga Lill në vitin 2012. Ndërkombëtar i Belgjikës ka folur më parë për admirimin e tij për "Los Blancos" dhe trajnerin e tyre, Zinedin Zidan. Hazard, i cili ka bërë disa nga paraqitjet e tij më të mira, me gjashtë gola dhe pesë asistime në 15 ndeshje, në të gjitha garat, këtë sezon, tha se ai ishte ende i lumtur te Çellsit. "Unë jam gjithmonë shumë mirë në këtë klub, kam ende dy vite kontratë. Kur ta ndiej dëshirën për t'u larguar, do të largohem, por për momentin jam një blu", tha ai për "Canal +". "Ju e dini admirimin që kam për Realin, por jam te Çellsit. Çdo vit, gjëra të ndryshme janë thënë për mua, por kam qëndruar te Çellsit. Edhe te Lill përflitesha se do të kaloja në Paris, por qëndrova. Edhe te Çellsit, njerëzit gjithnjë thanë që po largohesha, por jam ende këtu", deklaroi Hazard.



Aleks ose Martinez në vend të Ramiresit

Interi mund të transferojë Aleks Tekseira ose Rogjer Martinez, në vend të Ramires, nga Jiangsu Suning në janar. Të dy klubet janë në pronësi të "Suning Group", dhe muajin e kaluar ne pamë Trent Sainsbury të huazohej te Zikaltrit në rast emergjence në prapavijë. Muajin e fundit është raportuar se Ramires mund të mbërrijë me një marrëveshje të ngjashme, me Super Ligën kineze që fillon marsin tjetër. Gjithsesi, rregullat e reja e lojtarëve të juaj mund të ndryshojë situatën, siç e

ka shpjeguar "calciomercato.com". Teksa pesë lojtarë të huaj mund të regjistrohen nga një klub, vetëm tre lejohet të luajnë në një ndeshje. Momentalisht Jiangsu ka Sainsburu, Ramires, Tekseira, Martinez dhe Moukandjo në listën e lojtarëve. Klubi nuk kërkon të dobësojë mbrojtjen ose mesfushën, kështu që mendohet se njëri midis Tekseira dhe Martinez mund të sakrifikohen në mënyrë që Ikardi të ketë një zëvendësues të denjë.



Publicitet

Marrëveshja u arriti me një "selfie"

"Përshëndetje, jam trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp. Dëshiron të luash me ne?", ka qenë ky thelbi i bisedës mes Jurgen Klop dhe Ragnar Klavan. E gjitha nisi me një mesazh që trajneri gjerman i nisi futbollistit. Klavan mendoi se ishte një shaka, por menjëherë Klopp i nisi fotografinë e tij "selfie", që i konfirmonte se ishte trajneri në fjalë. Këtë episod kurioz e ka konfirmuar vetë futbollisti, që ka treguar për transferimin e tij nga Augsburg te Liverpooli, në verën e vitit 2016. "Është e vërtetë që më ka kontaktuar vetë Klopp dhe në fillim nuk e besova. I kërkoja një lloj konfirmimi para se të jepja përgjigje dhe Jurgen më nisi një foto "selfie". Menjëherë i thashë "po", deklaroi Klavan.

Në pajtim me nenin 22 të Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarive energjetike, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime EVROTIM GDS import-eksport SHPKNJ Kërçovë me seli në rr. Pitu Guli nr. 63, 6250 Kërçovë, Republika e Maqedonisë në vijim publikon:

LAJMËRIM

Informohet opinioni se Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime EVROTIM GDS import-eksport SHPKNJ Kërçovë me seli në rr. Pitu Guli nr. 63, 6250 Kërçovë, Republika e Maqedonisë më datë 15.08.2017 deri te Komisioni rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë ka parashtruar kërkesë për dhënie të licencës për kryerje të veprimtarisë energjetike tregti me shumicë me naftë të papërpunuar, derivate të naftës, bioderivate dhe derivate për transport-tregti me shumicë me mazut M-1 me UP1 nr. 11-98/17.

Emri i kërkuar:

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime EVROTIM GDS import-eksport SHPKNJ Kërçovë me seli në rr. Pitu Guli nr. 63, 6250 Kërçovë, Republika e Maqedonisë.

Lloji i veprimtarisë energjetike:

Veprimtarinë energjetike Tregti me shumicë me naftë të papërpunuar, derivate të naftës, bioderivate dhe derivate për transport-tregti me shumicë me mazut M-1 SHPTSH EVROTIM GDS import-eksport SHPKNJ Kërçovë do ta realizojë në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit..

Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë:

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime EVROTIM GDS import-eksport SHPKNJ Kërçovë pranimin dhe dërgimin e mazutit M-1 do ta kryejë përmes depon për mazut i cili gjendet në Resnjë në rr. Dimitar Vllahov pn Lista pronësore nr. 7229 për KK Resnjë, PK 4572/2 për të cilin ka marrëveshje për qira në pronën e patundshme më datë 21.07.2017 me pronarin AE-PETROL SHPKNJ f. Carev Dvor Resnje si qiradhënës..

Kohëzgjatja e licencës:

Kohëzgjatja është për dhjetë vjet.

Mënyra dhe afati përfundimtar për parashtrimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me kërkesën për marrje të licencës për tregti me shumicë me mazut M-1. Palët e interesuara, subjektet juridike dhe fizike mund me shkrim të parashtrorjnë deri tek Komisioni rregullator për energjetikë propozimet, mendimet dhe sugjerimet në lidhje me kërkesën për marrje të licencës për tregti me shumicë me mazut M-1 në afat prej pesë (5) ditëve nga publikimi në shtypin ditor.

Adresa e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë

Rr. Makedonija nr. 25 pallati Llazar Pop-Trajkov kati i 6 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë.

SHPTSH EVROTIM GDS SHPKNJ


MBAPPE, NEJMAR DHE KAVANI

DREJT REKORDEVE "GUINNESS"

Fitorja e PSZH-së ndaj Seltik Glasgow ishte për rekord, si individualisht, për tre protagonistët e saj Mbappe, Neymar dhe Kavani, edhe kolektivisht

Me fitoren në Paris kundër skocezëve, PSZH-ja ka shënuar 24 gola në pesë ndeshjet e fazës në grupe. Në mungesë edhe të një ndeshjeje të këtij raundi në Çampions, më mirë ka qenë vetëm Borussia Dortmund, sezonin e kaluar, që realizoi më shumë gola në historinë e fazës në grupe. Rekordi më i mirë deri në këtë sezon, në Ligën e Kampionëve, në fazën e grupeve, ishte 25 pikë në 10 ndeshje (2013-2014). Coleada e PSZH-së kishte pikë referimi tre yjet e saj të mëdha, të cilët ishin autorë të katër golave. Neymar u kthye në takimin e tij me gol në Ligën e

Kampionëve dhe tashmë ka pesë ndeshje radhazi që e bën këtë. Sulmuesi brazilian i PSZH-së ka sfiduar në këtë mënyrë Kristiano Ronaldo. Të dy janë një gol larg nga të bërit lojtari i parë që të shënon gol në gjashtë ndeshje të fazës së grupeve të Çampionsit. Neymar është në rrugën e tij për sezonin më të mirë në Ligën e Kampionëve. Që nga momenti kur braziliani erdhi në Evropë, sezoni 2013-2014, nuk kishte nënshkruar një fillim rezultativ aq të ndritshëm. Sezonin e parë nuk arriti të shënonte në pesë ndeshjet e para, një vit më vonë ishte te sezoni i tij i golave në Ligën e Kampionëve, me 10 pikë pas pesë ndeshjesh. Kavani, një nga golashënuesit e spikatur të parisienëve, shënoi golin e tij të 150-të me fanelën e PSZH-së. Uruguaiani është tashmë vetëm gjashtë gola larg nga Ibrahimoviç, me 156 gola, golashënuesi më i mirë në historinë e klubit gjigant të Ligue 1. Është hera e katërt që përbërësit e "tridentit" të formuar nga Mbappe, Neymar dhe Kavani shënojnë në të njëjtën ndeshje. Kjo ka ndodhur dy herë në Ligue 1 dhe dy herë në Ligën e Kampionëve. Të gjitha ndeshjet kanë përfunduar me "dajak" (PSG - Bordeaux 6-2; Seltik - PSZH 0-5; Anderlecht - PSZH 0-4; Metz - PSZH 1-5).



Rekordi i Ibrahimoviç

Zlatan Ibrahimoviç e ka futur emrin e tij në historinë e ligës së kampionëve, por fatkeqësisht për të, nuk ka ende shumë kohë për ta ngritur kupën me veshët e mëdhenj. Ibrahimoviç u bë lojtari i parë në historinë e këtij kompeticioni, që përfaqëson shtatë klube të ndryshme: Mançester, PSZH, Milan, Barcelona, Inter, Juventus dhe Ajaks. Suedezi, ende nuk ka arritur të fitojë Ligën e Kampionëve.



Ernesto Valverde

Ne kemi një ndjenjë të mirë. Kishim ardhur me synimin për të fituar, por edhe barazimi e përmbush misionin tonë. kemi luajtur me personalitet, sepse Juventus i ushtroi shumë presion. ka pasur shumë momente në ndeshje, kur kemi dominuar. Messi ka një akumulim të lojërave dhe mund të pushojë pak kohë, duke hyrë në gjysmën e dytë të ndeshjes. ky ishte vendimi. këto janë gjëra të karakterit të brendshëm, që trajnerët i trajtojnë

Karvahal hetohet nga UEFA

UEFA ka hapur një hetim ndaj mbrojtësit të Real Madrid, Dani Karvahal. Spanjollit akuzohet se e ka marrë me qëllim kartonin e verdhë në minutat e fundit të ndeshjes së luajtur në javën e pestë të Ligës së kampionëve kundër APOEL. Skuadra e Zinedin Zidane ka fituar 6-0 në Nikozi dhe arbitri portugez Artur Dias ka ndëshkuar Karvahal me karton të verdhë në minutën e 90-të të ndeshjes, pasi lojtari ka vonuar rivënien e topit në lojë. Ky episod ka shtyrë drejtuesit e UEFA-s të nisin hetimet. Sipas deklaratës së bërë nga UEFA, Karvahal ka shkelur nenin 15 të rregullores së disiplinës dhe komiteti i etikës do ta studiojë çështjen 7 dhjetorin e ardhshëm. Karvahal rrezikon të squalifikohet për dy ndeshje dhe rrezikon të mungojë në ndeshjen e fundit të fazës së grupeve kundër Borussia Dortmund dhe ndeshjen e parë të 1/8-ve.

Alkantara rrezikon mungesë të gjatë

Tiago Alcantara mund të qëndrojë disa muaj larg fushave të lojës, si pasojë e lëndimit që ka marrë gjatë ndeshjes së të mërkurës kundër Anderlechtit, që korrespondon me ditën e pestë të fazës së grupeve të Çampionsit. Ndeshja, e cila përfundoi me fitoren (1-2) të bavarezëve ndaj belgëve, u përbal në fund të pjesës së parë me Tiago Alcantara që kishte dhimbje në kofshën e këmbës së djathtë, ndaj kërkoi zëvendësim. Skanimet e para ndezën dritat e alarmit. Trajneri Jupp Heynkes tha se "Tiago ndoshta ka një lëndim të rëndë të muskujve". Drejtori sportiv i Bajern Muniht, Hasan Salihamixhiç, me një gjest shumë ekspresiv, tha se

"Tiago ka një dëmtim të rëndë të muskujve, ndoshta do të jetë jashtë fushe për disa muaj". Zherom Boateng, lojtar bavarez, në zonën e përzier, ishte i qartë: "Unë nuk jam mjek, por Tiago nuk duket mirë, ka shumë dhimbje dhe dukej shumë i dëshpëruar në dhomat e zhveshjes". Lëndimet e kanë penguar Alkantara nga vendosja e gjithë talentit të tij në veprim, sepse gjatë gjithë karrierës së tij, lojtari ka pësuar dy këputje të ligamentit dhe në 22 raste të një niveli më të madh ose më të vogël ai është lënduar.





DASHI 21. mars - 20. prill

Nëse jeni në çift mos merrni vendime impulsive gjatë kësaj dite sepse shumë shpejt do pendoheni. Nëse keni pasur probleme të mëdha nuk duhet të ndaheni pikërisht sot. Për beqaret, flirtet dhe aventurat do jete goxha të kënaqshme. Shfrytëzojini mundësitë që do iu jepen. Në planin financiar duhet të merrni masa strikte në mënyrë që të ruani qëndrueshmërinë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Priten disa probleme të vogla në çift gjatë kësaj dite, kështu që tregohuni me të matur me fjalët. Gjithsesi në fund të ditës situata do përmirësohet. Beqaret do kenë me shumë fat në dashuri dhe ka gjasa ta gjejnë atë që kanë kërkuar prej kohësh. Për shkak të kujdesit që keni treguar kohet e fundit për shpenzimet, sot financa do jete goxha të mira.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Fale konfigurimit jo të mire të Neptunit, ka rrezik që jeta juaj në çift të jete e mbushur me probleme dhe debate. Nëse e doni partnerin tuaj si me pare bëni gjithçka që ta ndryshoni situatën. Për beqaret do jete një ditë e mbushur me emocione të mëdha dhe takime interesante. Në planin financiar do keni mundësi të mira për ta stabilizuar situatën.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dielli do ndikojë pozitivisht sot në jetën tuaj në çift dhe do e beje ambientin me harmonik. Priten emocione të forta. Beqaret nga ana tjetër do jete edhe me të favorizuar në dashuri. Jupiteri do i nixte të tregohen të hapur ndaj takimeve dhe të shfrytëzojnë çdo propozim që do iu behet. Në planin financiar do luftoni fort që jo vetëm ta stabilizoni, por edhe ta përforconi situatën.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Jeta juaj në çift do shkojë për mrekulli gjatë kësaj dite. Gjithë gëzimi do reflektohet në të gjitha fushat e tjera të jetës dhe dita do jete e shkëlqyer. Beqaret nuk do takojnë dashurinë e madhe, megjithatë do kenë mundësi për aventura emocionuese. Shfrytëzojeni ditën! Në planin financiar fati do jete në anën tuaj. Buxheti do rritet ndjeshëm, por mos bëni menjëherë investime.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Do jeni shumë xhelozë pe rate që keni në krah gjatë kësaj dite dhe mund të bëni disa skena që nuk do i pëlqejnë partnerit. Kujdesuni të mos e lëndoni atë. Për beqaret do jete një ditë e veçantë gjatë se cilës do ndodhe një takim impresionues. Shfrytëzojeni atë deri në sekondën e fundit. Në planin financiar nuk duhet të luani me zjarin sepse mund të digjeni. Kujdes!



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Edhe pse mund të keni disa debate me partnerin tuaj gjatë kësaj dite, çdo gjë do rregullohet në shtat. Nuk mund t'i rezistoni dot atij kur ta keni aq pranë. Beqaret, fale ndikimit pozitiv të Hënës do hedhin hapet e para drejt një historie dashurie serioze dhe afatgjatë. Sektori i financave duhet pasur në qendër të vëmendjes. Mos shpenzoni pa u menduar nëse nuk doni të keni vështirësi.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Gjatë kësaj dite, ata që janë në një lidhje nuk do kenë as tabu dhe as gjera të ndaluara. Venusi do iu ndihmojë të tregoheni me të hapur dhe do tentoni risi. Për beqaret do ketë vetëm mundësi për aventura kalimtare, dashuria e madhe ende nuk do mbërrijë. Në planin financiar do negocioni me dike dhe do kryeni edhe transaksione me rëndësi.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Pas një periudhe jo dhe shumë të mire për jetën në çift, sot do bëni gjithçka që keni në dorë për të krijuar një ambient të ngrohtë. Dozat e komunikimit gjithashtu do shtohen mjaft. Beqaret do e lënë veten të lire dhe do bëjnë atë që do mendojnë për momentin. Financat do jete me të mira për personat të cilët kanë ndërmarrjet e tyre ose që merren me marrëdhënien me publikun.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Ju që jeni në një lidhje nuk do jeni aspak të duruar dhe mund të bëni gabime sot. Kujdes sepse partneri vërtet tregohet përgjithësisht i kuptueshëm, por çdo gjë e ka një kufi. Beqaret nuk do jete aspak në humor të mire për të filluar aventura kalimtare. Në planin financiar do kryeni transaksione të rëndësishme të cilat shumë shpejt do e përmirësojnë buxhetin.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Sot priten ndryshime të mëdha në jetën tuaj në çift. Do kaloni momente emocionuese me partnerin dhe do merrni vendime të rëndësishme së bashku. Beqaret nuk duhet të hedhin asnjë hap pa qene të sigurt se ai person është i duhuri. Mos iu besoni fjalëve të bukura. Financat do jete kryesisht të mira dhe nuk do keni për çfarë të qaheni. Beni shpenzimet e nevojshme.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Konfigurimi i yjeve do e beje jetën në çift edhe me të bukur sot. Do kaloni momente të këndshme dhe ambienti do jete harmonik. Megjithatë mire do ishte të mos tregoheshit shumë idealiste sepse edhe mund të zhgënjeheni. Beqaret do kenë njohje të reja me persona interesante. Sektori i financave do jete i ekuilibruar dhe aspak problematik.

shumë i lehtë

	2			5			6	
6	5						2	8
		3	6		2	9		
		7	1		8	2		
9								6
		2	5		6	8		
		5	3		9	6		
4	9						3	5
	3			7			8	


PËRKUJTIM



MUHAMET REXHA

21.09.1950-23.11.2007

Më 21 nëntor u mbushën dhjetë vite që nuk të kemi më pranë. Koha ikën shpejt, por malli për ty nuk shuhet. Jemi krenarë që të patëm ty. Kujtimi për ty do të mbetet gjithmonë në zemrat tona. E përkujton familja Rexha.



Mensur Mamuti	MBULESË KOKE GRASH (SHQ.)	SH	VRASËSI (NË MES) I ATENTATORIT TË KRYETARIT AMERIKAN	ATDHETARI GJERGJ GOLEMI, GJERGJ			
VËLLAI I BABAIT							
PIKTORI YNË KALESHI							
VOZITËSI AUSTRIAK, LAUDA							
KËNGËTARJA ITALIANE, RAFAELA							
ENERGJIA		UNITED NATIONS	KËNGËTARJA ZARI				
ISH FUTBOLLISTI YNË MUSTAFI							
KËNGËTARJA FRËNÇE, PIAF							
KOHA	NJË METAL (CO)	PËRPIQEM, MUNDOOHEM	0	QYTETI KU U BË VRASJA E ATENTATORIT (NË FOTO, MOMENTI I VRASJES)	LLOJ VRAPI TË KALIT	DRITËRO AGOLLI	KALIUMI
DIETAR I SHQUAR, MYSLIMAN, JUSUF EL		KOMPANI KOMPUTERIKE E TAJVANIT				VIOLETA DEDA	SËMUNDJA E SHEQERIT
ATENTATORI I KRYETARIT AMERIKAN, U (DJATHTAS)							NOTË MUZIKORE
KAFSHË SHTEPIAKE RIPERTY PËSE E DYTHUNDRAKE						JORDANI I VJETËR	REPUBLIKA E MAGEDONISË
HYJNËSHA FENIKASE						TURBO DIRECT INJECTION	VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE, SHTEG
LITRI		AUTORI YNË, MEKULI					ALI ARSLLANI
EKIPI, SKUADRA		IMPULSI					BERILIUMI
							DORËZOI
							TËRËSIA E DELEVE
							AZOTI
							KRYENECËSIA, KOKEFORTËSIA

ZGJIDHJET: SH, XHAXHA, OMER, NIKI, KARAJ, E, UN, NEBI, EDIT, O, DA, K, KARDAVI, DO, OSVALD, RIM, BUALLI, AMAN, ASTARTA, BE, L, ESAD, DHEN, TIMI, INATI.

GREKËT ME SEKS PO E LUFTOJNË KRIZËN!

Grekët si duket i janë "mësyre" seksit, pasi në një anketë lokale - ceket se marrëdhëniet seksuale të burrave të moshës mes 18 dhe 34 vjeç janë shtuar për 35 për qind në katër muajt e fundit të vitit në krahasim me periudhën e njëjtë në vitin 2016, kumtoi faqja greke Njus-In. Ky rezultat i papritur është nga anketa e Institutit Andrologjik në Athinë, e cila thekson se jeta seksuale e grekëve është bërë më intensive për shkak të krizës ekonomike dhe pasigurisë. Supozohet se aktiviteti i shtuar seksual është rezultat i reagimit vetëmbrojtës me të cilin grekët dëshirojnë t'i tejkalojnë vështirësitë me të cilat përballen dhe të cilat nuk mund t'i kontrollojnë. Anketa është bërë në formë të intervistës telefonike me pjesëmarrje 600 burra të moshës mes 25 dhe 64 vjeç. Burrat e mo-



shës prej 35 deri 54 vjeç kishin më shumë marrëdhënie seksuale për 30 për qind, ndërsa në mesin e burrave mbi 54 vjeç - është shtuar rritje për 27 për qind, thek-

sohet në rezultatet e Institutit Andrologjik. Në studim ceket më tej se një milion burra vuajnë nga problemi me ereksionin, që ka marrë përmasa të epidemisë.

PASAGJERËT NUK PARAQITEN, AVIONI FLUTURON VETËM PËR KËTË UDHËTARE



Me siguri ju ka ndodhur që të fluturoni me aeroplan, por vështirë që keni pasur fatin si kjo grua që kishte blerë biletën nga Glasgow i Skocisë në Kretë të Greqisë, transmeton Gazeta Metro. Shkrimtarja Karon Grieve pagoi rreth 50 euro në një avion me 189 ulëse. Gjëja speciale dhe që nuk ndodh gati asnjëherë është që ajo ishte e vetme në tërë avionin. 57 vjeçares iu tha në Check-In se do të ishte në aeroplan vetëm me dy persona të tjerë, por edhe çifti që kishte rezervuar bileta nuk u para-

qitën dhe ajo mbeti përfundimisht vetëm në avion. Pasi ajo mbeti vet, stafi e trajtoi shumë mirë duke i ofruar ushqim më të shtrenjtë se zakonisht, pasi askush tjetër nuk ishte në avion me të. Madje, edhe piloti e trajtoi shumë veçantë, duke e përmendur vetëm emrin e saj gjatë njoftimeve dhe pas aterimit. "Stafi më dha një karrige ku kisha shumë hapësirë për këmbët. Ishte fantastike", tha Karen duke përshkruar udhëtimin e jashtëzakonshëm të saj.

KUR DUHET TË USHQENI FËMIJËT ME MISH?

Në momentin që fëmija juaj është 6 muajsh, mund të filloni t'i jepni ushqime te ngurta, ndër të parat duhet të jenë drithërat ose frutat, perimet dhe në fund mishi. Por cila është moshja e duhur për t'i dhënë fëmijës mish? Këtë mund ta bëni

duke filluar nga muaji i 7-të dhe i 8-të duke e përzier me purenë e perimeve që tashmë keni filluar t'i jepni. Pureja e mishit duhet të jetë fillimisht e hollë. Mishi është një burim shumë i mirë proteinash, hekuri dhe zinku, të cilat janë mineralet

për të cilat fëmija ka më shumë nevojë nga moshja 6-12 muajsh. Ai gjithashtu është një burim magnezi dhe bakri. Hekuri dhe zinku që merret nga mishi absorbohet shumë me lehtësi nga fëmija.

VISHNI PAPUÇE NË SHTËPI!? JA ÇFARË PARALAJMËROJNË EKSPERTËT

Simptomat e artritit, ndër të cilat janë dhembjet dhe ënjtjet e nyjave në duar dhe këmbë, do të mund të përkeqësohen dhe të përshpejtohen për shkak të bartjes së papuçeve nëpër shtëpi. Ata tërheqin vërejtjen që bartja e papuçeve me kalimin e kohës mund të përkeqësojë mënyrën e ecjes, sepse në vend që të ecim, ne vërtet "rrëshqasim", nuk i ngremë këmbët shumë nga dyshemeja por vetëm i "tërheqim" me papuçe nëpër shtëpi. Ekspertët konsiderojnë se bartja e papuçeve mund të jetë njëri ndër faktorët për shkak të të cilit edhe personat e shëndetshëm mund ta ndiejnë dhembjen në nyja, e cila në të vërtetë është e ngarkuar me atë që



"bartin" papuçet me vete, prandaj shputat ju janë në pozitë jo të natyrshme. Dhembja në shputa për shkak të këpucëve të parehatshme është dukuri e shpeshtë edhe te të rinjtë, sepse rregullisht zgjedhin këpucë të cilat nuk u ofrojnë mbështetje shputave aq sa duhet. Te femrat është më e shpeshtë nëse bartin taka të

larta, mirëpo e gjitha përkeqësohet kur shputat "ftohën", pra ndoshta edhe vetë dikur keni ndier dhembje dhe inflamacion të shputave pikërisht në mëngjes kur jeni ngritur nga krevati. Këshilla e mjekëve para se të vijë dimri është që në vend të papuçeve të mbathni çorape të trasha, sepse në atë mënyrë shputat do t'i mbani mjaft të ngrohta edhe pa papuçe. Megjithatë, nëse nuk mund të ecni nëpër shtëpi pa papuçe, atëherë gjeni një palë të cilat nuk do të jenë vetëm "dollakë", por që do t'u ofrojnë mbështetje në tërësi shputave. Kështu shputat do të jenë në pozitë natyrore dhe nuk do t'i ngarkoni tepër nyjat.

380 - Teodori I bën hyrjen e tij formale në Konstantinopojë.
1105 - Rabini Nathan ben Yehiel i Romës përfundon Fjalorin Talmudik.
1434 - Ngrihet Lumi Temza.
1759 - Shpërthimi i Vullkanit të Vezufit.
1859 - Çarls Darvini boton "Origjina e Specieve".
1914 - Benito Musolini largohet nga Partia Socialiste e Italisë.
1915 - Udhëheqësit serb arrijnë në Shqipëri.
1935 - Mbreti Gjorgji II kthehet në Greqi pas 12 viteve.
1948 - Irlanda voton për pavarësi nga Britania e Madhe.
1949 - Britania nacionalizon industrinë e saj të çelikut dhe hekurit.
1954 - Franca dërgon 20,000 ushtar në Algjeri.
1958 - Mali shpallet shtet autonom në kuadër Komunitetit francez.
1966 - Nju Jorku përjeton ditën më me pluhur në historinë e tij.

Ish-marinsi amerikan Clint Emerson, autor i disa librave për ushtrime ushtarake, shpjegon se përse është e shëndetshme që duhin ta përfundojmë me ujë të ftohtë. "Uji i ftohtë do t'ju zgjojë, pa dyshim, dhe do t'ju mbajë zgjuar, por ka më shumë përfitime shëndetësore se çdo gjë tjetër. Në stërvitjen e forcave detare amerikane kaloni shumë kohë në ujë të ftohtë dhe ka një fakt shkencor për çmendurinë na fut në ujë të ftohtë. Një arsyeja pse atletët profesionistë e bëjnë këtë gjatë gjithë kohës pas një stërvitjeje, është se rritet shërimi. Ai vaksinon gjithë trupin, duke e zhveshur nga acidi laktik, në mënyrë që të ndjeheni mirë për të shkuar ditën tjetër dhe të jetë gati për trajnimin e ditëve të ardhshme", thotë Clint Emerson.



PUNA ME KAFSHË

Një turist kishte shkuar në lartësitë e maleve dhe pranë një stani takon një bari.
- Me çfarë merreni këtu gjatë gjithë vitit?
- Duhet të dish se kur merresh me kafshët ke gjithnjë punë. Në vjeshtë janë delet, gjatë dimrit dhitë, në pranverë lopët, kurse në verë vini ju turistët.



I kam ëndërruar pikturat e mia, dhe pastaj kam pikturuar ëndrrat e mia.
(Vincent van Gogh)



KALENDARI HISTORIK 24 NËNTOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS